

ÇDO VOTË DËSHET TË VLEJË!



ÇDO VOTË

DUHET

TË VLEJË!

TETOR 2018, PRISHTINË

COPYRIGHT © 2018.Kosova Democratic Institute (KDI)

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohet në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45,
10000, Prishtinë, Kosovë
Tel.: +383 (0)38 248 038
E-mail: info@kdi-kosova.org
Web: www.kdi-kosova.org

Autorë: **Eugen Cakolli**
Ahmet Rushiti
Blerta Aliu

Layout and design: **Rrota, www.rrota.com**

Vërejtje: Ky botim është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e KDI, dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SDC-së, DANIDA-së apo KCSF-së.

PËRMBAJTJA

HYRJE	5
1. SISTEMET ZGJEDHORE: KOSOVA DHE RAJONI	7
1.1 Historiku i zgjedhjeve në Kosovë dhe përpjekjet për reformimin e sistemit zgjedhor	9
1.2 Preferencat e subjekteve politike për sistemin zgjedhor të Kosovës (2018)	13
1.3 Sistemet zgjedhore të vendeve të rajonit	15
2. VOTAT E PAVLEFSHME	17
2.1 Fletëvotimet e pavlefshme në zgjedhjet në Kosovë 2009-2017: Shpërndarja dhe natyra e tyre	19
2.1.1 Shtrirja e votave të pavlefshme në zgjedhjet e përgjithshme, sipas komunave	22
2.1.2 Shtrirja e votave të pavlefshme në zgjedhjet lokale për kuvendet komunale, sipas komunave	22
2.1.3 Shtrirja e votave të pavlefshme në zgjedhjet lokale për kryetarë të komunave, sipas komunave	25
2.2. Shtrirja e votave e pavlefshme në Evropë	27
3. FUSHATAT PËR INFORMIM DHE EDUKIM TË VOTUESVE NË DY PALË ZGJEDHJET E FUNDIT NË KOSOVË	29
3.1 Zgjedhjet në Kosovë – përvoja e deritanishme e Fushatës së Informimit të Publikut	32
3.2 Infrastruktura ligjore dhe Strategjia për Informim të Publikut	34
3.3 Analizë kritike e aspektit profesional të fushatave informuese	36
3.4 Krahasset dhe Përvojat e Malit të Zi dhe Kroacisë	36
4. RAPORTI I HULUMTIMIT TË OPINIONIT PUBLIK “REFORMA ZGJEDHORE DHE VOTAT E PAVLEFSHME NË KOSOVË”	39
4.1 Perceptimet e përgjithshme qytetare mbi situatën politike	41
4.2 Pjesëmarrja e votuesve në dy proceset e kaluara zgjedhore	42
4.3 Çfarë sistemi zgjedhor preferojnë qytetarët e Kosovës	45
4.4 Testimi i dizajnit të ri të fletëvotimit për zgjedhjet e përgjithshme	48
PËRFUNDIMET	52
REKOMANDIMET	53
BIBLIOGRAFIA	56
SHTOJCA I – Pyetësori për preferencat e subjekteve politike lidhur me elementet e sistemit zgjedhor të Kosovës	57
SHTOJCA II – Dizajni i ri i fletëvotimit për zgjedhjet e përgjithshme parlamentare	58
SHTOJCA III – Dizajni i ri i fletëvotimit për zgjedhjet lokale për kuvendet komunale	60
SHTOJCA IV – Dizajni i ri i fletëvotimit për raundin e parë dhe të dytë zgjedhjeve lokale për kryetarë të komunave	62

HYRJE

Organizimi i zgjedhjeve të lira dhe demokratike është baza themeltare e një shoqërie demokratike. Kosova që prej vitit 2000, kur organizoi zgjedhjet e para të lira me ndihmën e UNMIK-ut dhe OSBE-së, ka krijuar një përvojë pozitive në organizimin e zgjedhjeve duke përmeshur shumicën e standardeve demokratike. Sidoqoftë, përkundër nivelit të kënaqshëm të organizimit të tyre, jo rrallëherë partitë politike kanë ngritur nevojën për reformimin e sistemit aktual zgjedhor, si mënyrë për përmirësimin e mëtutjeshëm të sistemit, me qëllim të adresimit të vullnetit të qytetarëve në mënyrë sa më të duhur. Në këtë drejtim, vullneti i qytetarëve, përpos zgjedhjeve e kontestuara gjerësisht të vitit 2010, është cenuar shpesh edhe për shkak të fletëvotimeve të pavlefshme, që si fenomen ka përcjellë të gjitha zgjedhjet e kaluara në Kosovë. Përgjatë katër cikleve të fundit zgjedhore, ky problem është evidentuar si një nga sfidat kryesore të procesit zgjedhor, si nga misionet vendore ashtu edhe ato ndërkombëtare për vëzhgim të zgjedhjeve. Përkundër faktit se kjo dukuri vazhdon të përsëritet nga zgjedhjet në zgjedhje, deri më tani janë bërë pak përpjekje institucionale për t'a trajtuar dhe përmirësuar këtë gjendje. Një nga arsyt kryesore është edhe mungesa e një baze të mirëfilltë hulumtuese, e cila do të ndihmonte në përcaktimin e faktorëve që kanë ndikuar në rritjen e vazhdueshme të numrit të votave të pavlefshme, dhe e cila do të ofronte një pasqyrë të qartë të shtrirjes gjeografike së këtyre votave. Faktor tjetër kyç është edhe mungesa e një auditimi gjithëpërfshirës të të gjitha votave të pavlefshme nga organet kompetente, që do të qonte në përcaktimin e natyrës së këtyre votave dhe shpërndarjes së tyre në nivel të gjithë Kosovës.

Roli i institucioneve kompetente për zgjedhje ka qenë pothuajse inekzistent edhe sa i përket edukimit të votuesve, derisa fushatat e kontraktuara nga jashtë deri më tani nuk kanë dhënë rezultatet e duhura. Fushatat për edukim dhe informim të votuesve përveç që nuk kanë kontinuitet dhe lansohen pak ditë para zgjedhjeve, ato shpërfaqin probleme përmbajtësore pasi vazhdojnë të servohen sipas shablloneve të vjetra, duke mos shënjestruar audienca specifike dhe duke mos tërhequr vëmendjen e votuesit. Si rezultat i mungesës së të dhënave të detajuara për votuesit, këto kampanja informuese dhe vetëdijësuese

nuk janë fokusuar në rajonet dhe zonat ku ka qenë më e nevojshme, por vetëm në kryeqendrat e Kosovës.


Numri i votave të pavlefshme ka arritur kulmin në zgjedhjet lokale të vitit 2013. Në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2014, kishte mbi 35 mijë vota të pavlefshme, ndërsa në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2017 ky numër u rrit në 42,554. Gjatë zgjedhjeve lokale të vitit 2017, numri i votave të pavlefshme është rritur sërish ndjeshëm, duke arritur në shifrën prej rreth 80 mijë sosh. Ky nivel i lartë i votave të pavlefshme ishte si rezultat i përdorimit të dy fletëvotimeve, atyre për kuvende komunale dhe për kryetarë komunash. Afërsia kohore mes dy palë zgjedhjeve të ndryshme supozohet të ketë ndikuar gjithashtu negativisht në votat e pavlefshme, marrë parasysht mënyrën e ndryshme të plotësimit të fletëvotimit për zgjedhjet parlamentare dhe fletëvotimeve për zgjedhjet lokale.

Marrë parasysht rezultatet tejte të ngushta në disa nga komunat kryesore gjatë zgjedhjeve të fundit lokale, mund të konstatohet se votat e pavlefshme kanë mundur të jenë vendimtare në përcaktimin e fituesit të zgjedhjeve. Disa nga komunat ku numri i votat të pavlefshme ka mundur të jetë vendimtar për përcaktimin e fituesve, janë Prishtina (365 vota diferenca – 627 vota të pavlefshme), Prizreni (372 vota diferenca – 494 vota të pavlefshme), Klllokoti (10 vota diferenca – 25 vota të pavlefshme), Istogu (14 vota dallimi – 139 vota të pavlefshme). Edhe sa i përket dy palë zgjedhjeve të fundit të përgjithshme, ku përqindja e votave të pavlefshme ka qenë rreth 5 për qind, kjo ka mundur të jetë po ashtu përcaktuese në renditjen e subjekteve politike dhe fituesve të zgjedhjeve.

Partitë politike, institucionet për administrimin e zgjedhjeve, misionet vëzhguese por edhe vetë qytetarët që kanë marrë pjesë në këto procese, kanë këndvështrime të ndryshme rreth asaj se pse është në rritje numri i votave të pavlefshme, përkundër faktit që zgjedhjet në Kosovë organizohen sipas legjislacionit që nuk ka ndryshuar prej rreth 10 vitesh. Institucionet për administrimin dhe organizimin e zgjedhjeve e arsyetojnë rritjen e numrit të votave të pavlefshme me afatet e shkurta kohore për organizimin e fushatave të mirëfillta dhe të detajuara për


Rreth 80 mijë

vota të pavlefshme në zgjedhjet lokale 2017



mënyrën e votimit; partitë politike fajësojnë njëra tjetrën se fletëvotimet mund të shpallen të pavlefshme gjatë procesit të numërimit të votave, ndërkaq vëzhguesit e zgjedhjeve vlerësojnë që ky proces është i ndërlidhur për shkak të mangësisë në fushatat për edukim të votuesve dhe mënyrës së administrimit të procesit zgjedhor. KQZ-ja ka nxjerrë raporte audituese për votat e pavlefshme në baza të rregullta kohore pas zgjedhjeve, mirëpo me gjithë rekomandimet e nxjerra deri më tani nuk janë ofruar masa konkrete për zbatimin e tyre, që do të ndikonin drejtpërdrejtë në zgjidhjen e këtij problemi.

E përbashkëta e rekomandimeve të hisedarëve në zgjedhje për votat e pavlefshme lidhet me përmirësimin e kapacitetit të votuesve që vota e tyre të jetë e vlefshme. Kjo nënkupton analizimin gjithëpërfshirës të faktorëve që kanë çuar në numër aq të lartë të fletëvotimeve të pavlefshme. Duke iu qasur këtij problemi në mënyrë analitike, do të krijohet një bazë e mirë intervenimi – rrjedhimisht një strategji e definuar mirë që do të përmbante objektiva dhe aktivitete konkrete sipas afateve të përcaktuara kohore.



SISTEMET ZGJEDHORE: KOSOVA DHE RAJONI

- 9** 1.1 Historiku i zgjedhjeve në Kosovë dhe përpjekjet për reformimin e sistemit zgjedhor
- 13** 1.2 Preferencat e subjekteve politike për sistemin zgjedhor të Kosovës [2018]
- 15** 1.3 Sistemet zgjedhore të vendeve të rajonit



1. SISTEMET ZGJEDHORE: KOSOVA DHE RAJONI

1.1 Historiku i zgjedhjeve në Kosovë dhe përpjekjet për reformimin e sistemit zgjedhor

Në tetor të vitit 2000, u mbajtën zgjedhjet e para në Kosovën e pasluftës. Pastaj, përgjatë një dekade, Kosova është përballur me cikle të tjera zgjedhore. Përveç se zhvillimit të dhjetëra proceseve zgjedhore, Kosova pësoi ndryshime edhe sa i përket karakteristikave të sistemit zgjedhor. Ndryshimet më të mëdha në sistemin zgjedhor, që nga krijimi i tij në vitin 2000, vërehen tek më 2007 si dhe pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës më 2008 dhe 2009.

Nga viti 2000, sistemi zgjedhor kosovar karakterizohej me përdorimin e sistemit proporcional të përfaqësimit, me formulë favorizuese për partitë politike të mesme ose të vogla, si në zgjedhjet për Kuvend të Kosovës ashtu edhe për Kuvende Komunale. Kurse në rastin e zgjedhjeve për kryetar komune është përdorur sistemi **"first-past-the-post"**. Promovimi i gjinisë më pak të përfaqësuar në proces ka qenë prezent që nga viti 2000.

Ajo periudhë u karakterizua edhe me trajtimin e posaçëm që i është ofruar komuniteteve jo-shumicë, me anë të vendeve të rezervuara në Kuvend të Kosovës dhe ndarjes së ulëseve sipas preferencës.

Një fushatë intensive e shoqërisë civile më 2003, ndikoi në hapjen e listave zgjedhore të subjekteve politike filluan të përdornin modelin e listave të hapura. Ato u përdorën për herë të parë në zgjedhjen e drejtpërdrejtë të

kryetarëve të komunave, në vitin 2007¹.

Hapja e listave imponoi edhe ndryshime teknike. Për të mos u rritur fletëvotimi, për shkaqe praktike emrat e kandidatëve që morën pjesë në zgjedhje nga secila parti u renditën në një libër/broshurë të veçantë, e cila vendosej në çdo kabinë votimi, praktikë kjo që vazhdon të përdoret edhe më tej.

Hapja e listave solli rrezikun që emrat e partisë që ndodheshin në pjesën e sipërme të listës të përfitonin padrejtësisht nga radhitja. Në një raport të organizate jo qeveritare kosovare D4D, shpjegohet se për të parandaluar një dominim të emrave të kreut të listës garuese, OSBE-ja lloboi në favor të përdorimit të votës preferenciale. Çdo votues në fillim duhej ta gjente partinë e preferuar dhe pastaj t'i identifikonte deri në dhjetë emra në listën prej 110 emrash kandidatësh, duke i shënuar pastaj numrat gjegjës në fletëvotim.

Shoqëria civile aso kohe pati avokuar edhe për tema të tjera, siç ishte mundësia e ndarjes së vendit në zona zgjedhore edhe për Zgjedhjet Parlamentare, ide kjo që nuk gjeti mbështetje, por u kundërshtua ashpër nga subjektet politike. Organizatat e shoqërisë civile besonin se krijimi i zonave zgjedhore do të kishte përparësi të mëdha. Më kryesorja do të ishte rritja e përfaqësimit të qytetarëve dhe ndërlidhja me e madhe në mes të deputetëve dhe qytetarëve. Një zonë e vetme zgjedhore do të përkthehej në llogaridhënie më të dobët, pothuajse inekzistente, mes votuesve dhe të zgjedhurve të tyre².

Një raport i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për Zgjedhjet në Kosovë nga 2000-2014, i publikuar në vitin 2017, i rendit ndryshimet e elementeve të sistemit zg-

¹ Demokraci për Zhvillim (D4D). "Trendet zgjedhore 2000-2014: Analizë numerike e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit". Prishtinë: Korrik, 2015.

² Instituti Demokratik i Kosovës (KDI). "Reforma në sistemin zgjedhor të Kosovës". Prishtinë: 2010.



jedhor si në vijim: përdorimin e përkohshëm të sistemit me lista të mbyllura, futja e pragut ligjor për subjektet politike që përfaqësojnë komunitetin shumicë, heqja e votimit në mungesë, dhe gjithashtu edhe përpilimi dhe ndërtimi i regjistrit të votuesve, ndryshimet në pushtetin e regjistrimit të partisë politike, ndryshimet në përbërjen e organeve menaxhuese zgjedhore, ndryshimin në sistemin e mjeteve juridike, etj.

Në po të njëjtin raport theksohet se që nga viti 2009, për zgjedhjen e anëtarëve të kuvendeve komunale, është zbatuar një variant special i sistemit të listës së hapur. Sipas këtij varianti votuesi nuk mund t'ia jep votën preferenciale udhëheqësit të listës (kandidatit nr. 1 në listë), por vetëm kandidatëve të tjerë. Udhëheqësi i listës konsiderohet ta ketë marrë votën preferenciale me automatizëm.

Në variantin e sistemit zgjedhor me lista të mbyllura, votuesi nuk mund ta japë fare votën preferenciale, ndaj kandidatët marrin mandatin në renditjen e përcaktuar nga subjekti politik para zgjedhjeve.

Që nga viti 2007, subjektet politike të cilat garojnë në zgjedhje për Kuvend të Kosovës është dashur që të kalojnë prapun zgjedhor prej 5 për qind të numrit të përgjithshëm të votave të vlefshme për të marrë pjesë në ndarjen e ulëseve.

Nga ana tjetër, nga viti 2000 komuniteteve jo shumicë u janë ndarë ulëse në Kuvendin e Kosovës, të paktën nga 20 sosh në secilën përbërje. Bëhet fjalë për modelin e ulëseve të rezervuara, i cili ka funksionuar deri në vitin 2010. Ky model u ofronte mundësinë subjekteve politike të komuniteteve jo shumicë të kenë ulëse krahas atyre që fitonin nga votat direkte të votuesve..

Kjo gjë ndryshoi në vitin 2014, kur ulëset e rezervuara u shndërruan në ulëse të garantuara. Kjo nënkupton se subjektet politike të cilat përfaqësojnë komunitetet jo-shumicë në Kosovë, kanë të garantuara 20 ulëse në Kuvendin e Kosovës, ndërsa nëse marrin më shumë vota sesa numrin prej 20 ulëseve, atyre u shpërndahen ulëse shtesë.

Megjithatë, për të parë në detaje se si kanë ndryshuar elementet e sistemit zgjedhor që nga viti 2000 deri në zgjedhjet e fundit të 2017-s, në vijim gjeni të prezantuar në formë tabelare të dhënat për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, Zgjedhjet për Kuvend Komunal si dhe Zgjedhjet për Kryetar Komunalash. Elementet të cilat janë ofruar në dispozicion në këto tabela lidhen me sistemin zgjedhor, listat e kandidatëve, votimin, zonat, numrin e ulëseve, ulëset e veçanta, prapun zgjedhor, metodat e ndarjes së ulëseve si dhe kuotën gjinore. Të gjitha informatat e prezantuar në tabela janë mbështetur në të dhënat publike të KQZ-së.

	KUVENDI I KOSOVËS 2001	KUVENDI I KOSOVËS 2004	KUVENDI I KOSOVËS 2007	KUVENDI I KOSOVËS 2010	KUVENDI I KOSOVËS 2014	KUVENDI I KOSOVËS 2017
Sistemi zgjedhor	Përfaqësim Proporcional	Përfaqësim Proporcional	Përfaqësim Proporcional	Përfaqësim Proporcional	Përfaqësim Proporcional	Përfaqësim Proporcional
Lista e kandidatëve	Mbyllur	Mbyllur	Hapur	Hapur	Hapur	Hapur
Votimi për	Vetëm subjektin	Vetëm subjektin	Subjektin dhe deri në 10 kandidatë	Subjektin dhe deri në 5 kandidatë	Subjektin dhe deri në 5 kandidatë	Subjektin dhe deri në 5 kandidatë
Zonat	Një zonë	Një zonë	Një zonë	Një zonë	Një zonë	Një zonë
Gjithsej ulëse	120	120	120	120	120	120
Ulëset e veçanta	20 të rezervuara	20 të rezervuara	20 të rezervuara	20 të rezervuara	20 të garantuara	20 të garantuara
Pragu	-	-	5%	5%	5%	5%
Metoda e ndarjes së ulëseve	Koeficienti më i lartë (Sainte-Laguë)	Koeficienti më i lartë (Sainte-Laguë)	Koeficienti më i lartë (Sainte-Laguë)	Koeficienti më i lartë (Sainte-Laguë)	Koeficienti më i lartë (Sainte-Laguë)	Koeficienti më i lartë (Sainte-Laguë)
Kuota gjinore	30%	30%	30%	30%	30%	30%

Tabela 1. Pasqyrë e elementeve të sistemit zgjedhor për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës për vitet 2000-2017³

3 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. "Zgjedhjet në Kosovë 2000 – 2014". Prishtinë: 2017.

Në tabelën e mësipërme, janë të renditura karakteristikat e sistemit zgjedhor në Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës për gjashtë vite sa janë organizuar, përkatësisht për vitet: 2001, 2004, 2007, 2010, 2014 dhe 2017. Modeli zgjedhor i aplikuar në të gjitha këto zgjedhje është ai proporcional..

Kurse lista e kandidatëve ka pësuar ndryshime dhe nga opsioni i listave të mbyllura është kaluar në ato të hapura më 2007. Ndryshimet e kanë prekur edhe mënyrën e votimit, e cila i është nënshtruar ndryshimeve edhe dy herë të tjera.

Në zgjedhjet e vitit 2001 dhe ato të 2004-s është votuar vetëm për subjektin politik, përderisa në vitin 2007 është votuar për subjektin dhe 10 kandidatë të tij. Sërish në vitin 2010, ndodhi ndryshimi i radhës. Votuesve ju ofrua mundësia që të votojnë për subjektin dhe maksimalisht pesë kandidatë të tij. Ky model u aplikua në zgjedhjet e vitit 2013 si dhe ato të fundit, të vitit 2017.

Kur jemi te zonat zgjedhore, të gjitha Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës janë organizuar në një zonë të vetme.

I pandryshueshëm mbetet që nga viti 2001 edhe numri i ulëseve në Kuvend dhe i cili sipas legjislacionit në fuqi është 120. Edhe numri i ulëseve të veçanta nuk ka ndërruar që nga atëherë duke mbetur 20 sosh.

Një ndryshim tjetër që paraqitet në 2007-n është aplikimi i pragut zgjedhor prej 5 për qind, i cili është përdorur më 2010, 2013 dhe 2017. Modeli i ndarjes së ulëseve është bërë gjithmonë sipas koeficientit më të lartë (**Sainte-Laguë**). Ndërkaq kuota gjinore është ulur për 3 për qind nga viti 2007, teksa në zgjedhjet pasuese është në masën 30 për qind.

Në tabelën e dytë, janë të renditura karakteristikat e sistemit zgjedhor në Zgjedhjet për Kuvend Komunal, për gjashtë vite sa janë organizuar, përkatësisht për vitet: 2000, 2002, 2007, 2009, 2013 dhe 2017. Edhe në këto zgjedhje kemi të bëjmë me sistem zgjedhor proporcional i cili është aplikuar që nga zgjedhjet e para të pasluftës në Kosovë në vitin 2000. Kurse lista e kandidatëve u hapën në zgjedhjet e 2007 dhe vazhdojnë të qëndrojnë kështu.

	KUVEND KOMUNAL 2000	KUVEND KOMUNAL 2002	KUVENDI KOMUNAL 2007	KUVENDI KOMUNAL 2009	KUVENDI KOMUNAL 2013	KUVENDI KOMUNAL 2017
Sistemi zgjedhor	Përfaqësim Proporcional	Përfaqësim Proporcional	Përfaqësim Proporcional	Përfaqësim Proporcional	Përfaqësim Proporcional	Përfaqësim Proporcional
Lista e kandidatëve	Hapur	Mbyllur	Hapur	Hapur	Hapur	Hapur
Votimi për:	Subjektin dhe vetëm një kandidat	Vetëm subjektin	Subjektin dhe deri në 10 kandidatë	Subjektin dhe vetëm një kandidat	Subjektin dhe vetëm një kandidat	Subjektin dhe vetëm një kandidat
Zonat (secila komunë konsiderohet një zonë e vetme zgjedhore)	30	30	30	36	38	38
Gjithsej ulëse	920	920	920	1,021	994	994
Ulëset e veçanta	N/Z	N/Z	N/Z	N/Z	N/Z	N/Z
Pragu	-	-	-	-	-	-
Metoda e ndarjes së ulëseve	Koeficienti më i lartë (Sainte- Laguë)	Koeficienti më i lartë (Sainte- Laguë)	Koeficienti më i lartë (Sainte- Laguë)	Koeficienti më i lartë (Sainte- Laguë)	Koeficienti më i lartë (Sainte- Laguë)	Koeficienti më i lartë (Sainte- Laguë)
Kuota gjinore	30%	30%	30%	30%	30%	30%

Tabela 2. Pasqyrë e elementeve të sistemit zgjedhor për Zgjedhjet për Kuvendet Komunale për vitet 2000-2017⁴

⁴ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. “Zgjedhjet në Kosovë 2000 – 2014”. Prishtinë: 2017.

Në të gjitha zgjedhjet është aplikuar sistem zgjedhor me dy raunde (balotazh).

Tabela 3. Pasqyrë e elementeve të sistemit zgjedhor për Zgjedhjet për Kryetarë të Komunave për vitet 2000-2017⁵

1.2 Preferencat e subjekteve politike për sistemin zgjedhor të Kosovës (2018)

Iniciativat për reformimin e sistemit zgjedhor kanë qenë jo të rralla në historinë politike të Kosovës që nga paslufta. Mirëpo, bazuar në rezultatet që kanë sjellë iniciativat e deritanishme për reformën zgjedhore, mund të konstatohet se ka ekzistuar një mungesë e thellë e vullnetit e spektrit politik, për ta çuar në fund këtë proces. Kjo, përveç në rastet kur një proces i tillë është shtyrë nga ndërkombëtarët. Kësaj i shtohet edhe fakti se qëndrimet dhe preferencat e subjekteve politike mbi atë se si duhet të duket sistemi zgjedhor i Kosovës, përgjithësisht nuk janë të përafërta.

Në kuadër të projektit "Çdo votë duhet të vlejë!", Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka zhvilluar një pyetësor⁶ përmes së cilit janë pyetur subjektet politike mbi preferencat e tyre për elemente të caktuara të sistemit zgjedhor. Vlen të ceket se gjatë zhvillimit intervistave me subjektet politike, gjatë muajve korrik dhe gusht, është evidentuar një kundërshti e qëndrimeve të subjekteve politike në pozitë dhe atyre opozitare, mbi atë nëse duhet të shkohet në zgjedhje të parakohshme me sistemin aktual. Derisa subjektet politike që janë në pozitë kërkojnë që reforma zgjedhore të përfundohet brenda këtij mandati, pra deri në fund të vitit 2021, subjektet opozitare po refuzojnë të jenë pjesë e procesit të reformës zgjedhore, me arsyetimin se me procese të tilla qeveria kërkon të blejë kohë shtesë për të evituar zgjedhjet, siç ka ndodhur edhe në rastet e kaluara. Sipas tyre, reforma zgjedhore duhet të jetë prioritet i legjislaturës së ardhshme, pas mbajtjes së zgjedhjeve të parakohshme parlamentare.

Sipas përgjigjeve të marra nga subjektet politike⁷, të cilat janë pasqyruar në tabelën në vijim, mund të konkludohet se pothuajse të gjitha subjektet, përpos Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, preferojnë që Kosova të vazhdojë ta ketë sistemin zgjedhor proporcional. Subjektet politike kanë preferencat të njëjta edhe në lidhje me listat zgjedhore, të cilat, sipas tyre, duhet të vazhdojnë të mbeten të hapura⁸.

Në këtë drejtim, dallime ekzistojnë vetëm sa i përket votës preferenciale, gjegjësisht numrit të kandidatëve, të cilët votuesit duhet të kenë të drejtë t'i votojnë në zgjedhjet parlamentare.

Sa i përket zonave zgjedhore, ekzistojnë dallime të theksuara në mes subjekteve politike, si në numrin e zonave dhe arsyeshmërinë, po ashtu edhe në mënyrën e caktimit të tyre. Lëvizja Vetëvendosje dhe Nisma Socialdemokrate preferojnë që Kosova të mbetet vetëm me një zonë zgjedhore, meqenëse, sipas tyre, Kosova ka sipërfaqe dhe numër jo të madh të popullsisë. Sipas tyre me këtë model garantohet edhe karakteri unitar i shtetit. Aleanca Kosova e Re dhe Partia Demokratike, në anën tjetër, përkrahin idenë e ndarjes së Kosovës në shtatë zona zgjedhore, sipas ndarjes aktuale administrative të gjykatave, apo drejtorive të Policisë së Kosovës. Ndërsa, sipas Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Kosova duhet të ndahet në gjashtë zona zgjedhore.

Dallime në preferencat e subjekteve politike, ekzistojnë edhe sa i përket pragut zgjedhor që duhet të aplikohet për zgjedhjet e nivelit qendror. E vetmja pajtueshmëri në këtë drejtim, është se në përgjithësi shumica e subjekteve politike vlerësojnë se duhet të ketë kategorizim të kuotës, varësisht se a kandidohet në zgjedhje parlamentare si koalicion, parti politike apo kandidat i pavarur. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës ka deklaruar se preferon që pragu zgjedhor për koalicione të jetë 7 për qind, për parti politike 5 për qind, ndërsa për kandidatë të pavarur 2 për qind.

Kategorizim pothuajse të njëjtë ka preferuar edhe Lëvizja Vetëvendosje, me dallimin e vetëm tek kuota për kandidatë të pavarur, e cila sipas tyre duhet të jetë 2.5 për qind. Aleanca Kosova e Re ka deklaruar se preferon që të ketë ulje dhe kategorizim të pragut zgjedhor. Sipas tyre, pragu zgjedhor prej 5 për qind duhet të vlejë vetëm për koalicionet, për partitë politike duhet të vlejë pragu zgjedhor prej 3 për qind, ndërsa për kandidatë të pavarur duhet të ketë prag prej 1 deri në 2 për qind. Kurse, Partia Demokratike e Kosovës ka deklaruar se pragu për koalicione duhet të rritet, ndërsa pragu për kandidatë të pavarur të ulet pa specifikuar se sa duhet të jetë kjo përqindje. Sipas tyre,

6 Për më shumë, shih Shtojcën I të këtij punimi.

7 Subjektet politike Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Partia Socialdemokrate (PSD) dhe Alternativa nuk janë përgjigjur në pyetjet e këtij pyetësori.

8 Sipas Nismës Socialdemokrate, vota për një subjekt politik duhet të nënkuptohet automatikisht si votë për bartësin e listës, njësoj sikur për zgjedhjet e nivelit lokal.

Tabela 4. Preferencat e subjekteve politike lidhur me elementet e sistemit qzjedhor

Mënyra e zgjedhjes së presidentit të Kosovës është një nga çështjet ku ekzistojnë dallime substanciale. Aleanca Kosova e Re, e cila e ka pasur këtë çështje si pjesë

Në anën tjetër, Lëvizja Vetëvendosje dhe Nisma Socialdemokrate, vlerësojnë se presidenti i Kosovës duhet të vazhdojë të zgjedhet nga Kuvendi i Kosovës, marrë parasysh rregullimin politiko-juridik të vendit,

si republikë parlamentare. Sipas këtyre subjekteve, mënyra aktuale e zgjedhjes së presidentit, garanton mos përqendrim të pushtetit ekzekutiv tek një person i vetëm, meqenëse me zgjedhjen e drejtpërdrejtë të Presidentit të Kosovës, pashmangshëm do të hapej diskutimi edhe për rritjen e kompetencave të presidentit, apo edhe ripërcaktimi i rregullimit politik të Kosovës, si vend me sistem gjysmë-presidencial.

Kurse, për Partinë Demokratike të Kosovës, çështja e mënyrës së zgjedhjes së presidentit është e ndërlidhur ekskluzivisht me kompetencat, të cilat i ka ai aktualisht. Rrjedhimisht, ky subjekt kërkon ndryshime kushtetuese, gjë që në situatën e tanishme, është vështirë e arritshme.

Shumica e subjekteve politike kanë deklaruar se votimi me kusht duhet të vazhdojë të aplikohet, përkundër faktit se situata dhe arsyeja për të cilën është imponuar ky model nuk ekziston më. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Aleanca Kosova e Re dhe Lëvizja Vetëvendosje preferojnë që kjo mënyrë e votimit duhet të vazhdojë të aplikohet, kurse Nisma Socialdemokrate dhe Partia Demokratike e Kosovës kanë deklaruar se nga problemet që janë evidentuar përgjatë proceseve të kaluara zgjedhore, do të duhej që votimi me kusht të hiqej. Sipas Partisë Demokratike të Kosovës, në mënyrë që të hiqet përfundimisht votimi me kusht, do të duhej që paraprakisht të ketë pastrim të listës aktuale të votuesve, përmirësim të adresave të banimit, dhe një varg tjetër veprimesh, nëpërmjet të cilave qytetarëve u garantohet e drejta e votës, sa më afër vendbanimit të tyre. Ndërsa për votimin nga jashtë, veçse ekziston një konsensus i plotë mes subjekteve kryesore politike, që si element i sistemit zgjedhor, të vazhdojë të zbatohet edhe përgjatë cikleve të ardhshme zgjedhore.

Aplikimi i kuotës gjinore prej 30 për qind dhe ndryshimi i dizajnit aktual të fletëvotimit, janë dy tema ku ekziston pajtueshmëri e plotë në mes të gjitha subjekteve politike që janë përgjigjur në pyetjet e pyetësorit për preferencat e subjekteve politike për elementet e sistemit zgjedhor.

1.3 Sistemet zgjedhore të vendeve të rajonit

Përkundër faktit që të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor kanë sistem të ngjashëm të rregullimit shtetëror, sistemet zgjedhore të tyre dallojnë esencialisht në disa elemente kryesore, siç janë: listat zgjedhore, zona zgjedhore dhe pragu zgjedhor. Në këtë seksion, do të bëhet një përshkrim i sistemeve zgjedhore të shteteve të Ballkanit Perëndimor, për zgjedhjet e nivelit qendror, si dhe do të paraqiten në formë tabelare karakteristikat kryesore të sistemeve zgjedhore të tyre.

E përbashkëta e të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor sa i përket sistemit zgjedhor, është sistemi proporcional i votimit. Kosova dhe Bosnje e Hercegovina janë shtetet e vetme të Ballkanit Perëndimor që kanë lista zgjedhore të hapura ndërsa votimi është preferencial, me të cilin votuesit kanë mundësi të zgjedhin deri në pesë kandidatë të subjektit në fjalë. Mali i Zi, Maqedonia, Serbia dhe Shqipëria aplikojnë sistemin e listave të mbyllura.

Sa i përket rregullimit zonal, Kosova ka vetëm një zonë zgjedhore, sikurse edhe Mali i Zi e Serbia. Numrin më të madh të zonave zgjedhore, nga shtet e Ballkanit Perëndimor, e ka Shqipëria, me gjithsej 12 zona zgjedhore. Pas Shqipërisë renditet Bosnje e Hercegovina me 9 zona zgjedhore dhe Maqedonia me 7 zona zgjedhore, prej të cilave një zonë është e dedikuar ekskluzivisht për diasporën, e cila ka të garantuara tri ulëse në Kuvendin e Maqedonisë. Vlen të ceket se Bosnje e Hercegovina ka sistemin më të komplikuar zgjedhor në mesin e vendeve të tjera të këtij rajoni. Kjo si rrjedhojë e vetë organizimit të brendshëm shtetëror të këtij shteti, dhe ndarjeve në shumë zona dhe distrikte etnike.

Pragu zgjedhor, është një nga elementet e sistemit zgjedhor për të cilin ekziston një ndarje më dysh e shteteve. Një grup i shteteve, ku hyn Bosnja dhe Hercegovina dhe Malin e Zi⁹, aplikojnë prag zgjedhor prej 3 për qind. Kurse,

⁹ Mali i Zi, përpos kuotës prej 3 për qind në nivel qendror, aplikon kuota më të ulëta për grupet minoritare. Për grupet etnike të cilat përfaqësojnë së paku 15 për qind të popullsisë, aplikohet kuotë prej 0.7 për qind. Kurse minoriteti kroat, nëse nuk arrin të kalojë kuotën prej 0.7 për qind, atëherë atyre u ofrohet një ulëse, në situatën kur ata kanë fituar së paku 0.35 për qind të numrit të përgjithshëm të votave të vlefshme.

grupi tjetër i shteteve, ku bën pjesë: Kosova, Maqedonia dhe Serbia, aplikojnë prag zgjedhor prej 5 për qind.

Maqedonia dhe Serbia aplikojnë kuota më të ulëta për subjektet politike që deklarohen se përfaqësojnë një nga minoritetet etnike. Kosova ka standard më të lartë të përf-

shirjes së minoriteteve në vendimmarrje, meqenëse aplikon ulëset e garantuara për komunitetet jo-shumicë¹⁰. Ndërsa, Shqipëria, aplikon pragje të kategorizuara zgjedhore, meqë për partitë politike që garojnë të vetme në zgjedhje zbatohet pragu prej 3 për qind, ndërsa për koalicionet e dy apo më shumë partive, pragu prej 5 për qind.

Shteti	Sistemi i votimit	Listat zgjedhore	Zonat zgjedhore	Pragu zgjedhor
Bosnja dhe Hercegovina	Proporcional	Lista të hapura (<i>Votim preferencial</i>)	9	3%
Kosova	Proporcional	Lista të hapura (<i>Votim preferencial</i>)	1	5%
Mali i Zi	Proporcional	Lista të mbyllura	1	3%
Maqedonia	Proporcional	Lista të mbyllura	6 +1 (<i>për diasporën</i>)	5%
Serbia	Proporcional	Lista të mbyllura	1	5%
Shqipëria	Proporcional	Lista të mbyllura	12	3% për partitë politike 5% për koalicione

Tabela 5. Sistemet zgjedhore të shteteve të Ballkanit Perëndimor

10 Sipas legjisllacionit në Kosovë, komunitetet jo-shumicë kanë të garantuara 20 ulëse në Kuvendin e Kosovës. Këto ulëse fitohen nga subjektet që kanë fituar më së shumti vota, duke aplikuar metodën D'Hondt.

2

VOTAT E PAVLEFSHME

- 19** 2.1 Fletëvotimet e pavlefshme në zgjedhjet në Kosovë 2009-2017: Shpërndarja dhe natyra e tyre
- 27** 2.2 Shtrirja e votave e pavlefshme në Evropë



2. VOTAT E PAVLEFSHME

2.1 Fletëvotimet e pavlefshme në zgjedhjet në Kosovë 2009-2017: Shpërndarja dhe natyra e tyre

Që nga shpallja e Pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, në Kosovë janë organizuar gjashtë palë zgjedhje. Prej tyre, tri palë ishin të nivelit qendror, ndërsa tri të tjera të nivelit lokal.

Dukuria e numrit të madh të votave të pavlefshme është evidentuar të jetë një nga elementet më negative të proceseve zgjedhore. Rrjedhimisht, ajo ka ndikuar jo rrallëherë në cenimin e integritetit të të gjithë procesit, si pasojë e pretendimeve për manipulime të qëllimshme. Nëse merren për bazë rezultatet e zgjedhjeve të fundit të përgjithshme, dhe krahasohen me vendet tjera të Evropës, atëherë del se Kosova renditet në vendin e pestë për nga përqindja më e lartë e fletëvotimeve të pavlefshme.

Bazuar në statistikat lidhur me votat e pavlefshme, mund të konstatohet se trendet e tyre tregojnë se koncentrimi i votave të pavlefshme është dukshëm më i lartë në zgjedhjet e nivelit lokal, posaçërisht në zgjedhjet për kuvendet komunale. Nëse shikohen proceset zgjedhore që pas shpalljes së pavarësisë, periudhë gjatë së cilës janë zhvilluar gjashtë procese zgjedhore, prej tyre tri të nivelit qendror dhe tri tjera të nivelit lokal. Mesatarja e votave të pavlefshme për tri palë zgjedhjet e përgjithshme është rreth 4.5 për qind, për zgjedhjet lokale, përkatësisht për kuvende komunale rreth 8 për qind, dhe për kryetarë të komunave rreth 1.7 për qind.

Të parat zgjedhje që janë organizuar në Kosovë pas vitit 2008, ishin zgjedhjet e nivelit lokal në vitin 2009. Në këto zgjedhje, ku morën pjesë rreth 700 mijë votues, rreth 65 mijë vota ishin shpallur të pavlefshme, prej të cilave

53,083 (7.6 për qind) ishin fletëvotime për kuvendet komunale, ndërsa 10,990 (1.5 për qind) ishin fletëvotime për kryetarë të komunave.

Pas këtyre zgjedhjeve, në vitin 2010 u organizuan zgjedhjet e parakohshme parlamentare, zgjedhje në të cilat 29,217 fletëvotime, apo 3.95 për qind e numrit të përgjithshëm të votave u shpallën të pavlefshme.

Në zgjedhjet lokale të vitit 2013, u shënua numri më i madh i fletëvotimeve të pavlefshme. Krahasuar me zgjedhjet paraprake të nivelit lokal, kishte një rritje prej më shumë se 20 mijë fletëvotimeve të pavlefshme. Në këto zgjedhje ishin evidentuar 70,782 fletëvotime të pavlefshme vetëm në kuadër të fletëvotimeve për kuvende komunale, që si numër i përgjithshëm është më i madh se të gjitha fletëvotimet e pavlefshme në zgjedhjet lokale të vitit 2009. Mbi 15 mijë fletëvotime për kryetarë të komunave, ishin shpallur po ashtu të pavlefshme në këto zgjedhje.

Duke pasur parasysh një numër kaq të madh të votave të pavlefshme, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kishte kërkuar nga një komision i posaçëm hetimin e natyrës së pavlefshmërisë së këtyre fletëvotimeve¹¹.

Ky komision kishte përzgjedhur si mostër 100 vendvotime, duke analizuar gjithsej 5,846 fletëvotime të pavlefshme. Sipas rezultateve të kësaj analize, për nga natyra e pavlefshmërisë së tyre, fletëvotimet mund të ndahen në këto grupe¹²:

- Fletëvotimet ku nuk është shënuar subjekti politik, por vetëm kandidati (80.75 për qind);
- Fletëvotimet në të cilat është shënuar më shumë se një subjekt politik (9.26 për qind);
- Fletëvotimet e vlefshme, por që janë shpallur si të pavlefshme nga Këshillat e Vendvotimeve (3.97 për qind);
- Fletëvotimet e dëmtuara qëllimisht (3.63 për qind);
- Fletëvotimet e paplotësuara (1.95 për qind).

¹¹ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. "Hulumtimi dhe analizimi i fletëvotimeve të pavlefshme për zgjedhjet për kuvendin komunal 2013". Prishtinë: 2014. Fq. 2. Për më shumë, shih: http://www.kqz-ks.org/wp-content/uploads/2018/02/Raporti-i-hetimit-te-flv-2013_al.pdf

¹² Po aty. Fq. 3



|||||

Trend dhe numër i ngjashëm i votave të pavlefshme, përkatësisht rreth 1 mijë fletëvotime të pavlefshme më shumë se në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2010, ishin evidentuar edhe në zgjedhjet, sërish të parakohshme, parlamentare të vitit 2014. Përkundër rekomandimeve të shumta lidhur me përmirësimin e gjendjes sa i përket votave të pavlefshme, edhe në këto zgjedhje 30,647 fletëvotime, apo rreth 4 për qind e numrit të përgjithshëm të fletëvotimeve, ishin shpallur të pavlefshme. Për nga natyra e pavlefshmërisë, fletëvotimet e pavlefshme të zgjedhjeve të 2014 janë si në vijim¹³:

- 1) Fletëvotime në të cilat është shënuar kandidati, kurse nuk është shënuar subjekti politik – 45.83 për qind;
- 2) Fletëvotime ku është shënuar më shumë se një subjekt politik – 42.72 për qind;
- 3) Fletëvotime të dëmtuara qëllimisht – 6.85 për qind;
- 4) Fletëvotime të paplotësuara – 2.97 për qind;
- 5) Fletëvotime të pavullosura – 0.9 për qind;
- 6) Fletëvotimet e vlefshme, por që janë shpallur si të pavlefshme nga Këshillat e Vendvotimeve – 0.73 për qind.

Viti 2017, është viti kur janë mbajtur zgjedhjet e nivelit qendror dhe ato lokal, edhe pse vetëm këto të fundit sipas afatit të rregullt ligjor. Në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të mbajtura më 11 qershor, për herë të parë përqindja e fletëvotimeve të pavlefshme, thënë kushtimisht, kishte kaluar pragun zgjedhor duke arritur shifrën prej 5.48 për qind. Kjo përqindje e fletëvotimeve të pavlefshme është më e larta ndonjëherë në zgjedhjet e përgjithshme parlamentare. Krahasuar me zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2013 kur numri i fletëvotimeve të pavlefshme arriti në rreth 30 mijë sosh, në zgjedhjet e vitit 2017 ky numër u rrit për mbi 10 mijë, duke arritur në gjithsej 42,554 fletëvotime të pavlefshme në tërë Kosovën.

Ndërsa në zgjedhjet lokale të mbajtura në tetor të vitit 2017, kemi pasur një rënie të lehtë të numrit, përkatësisht përqindjes së fletëvotimeve të pavlefshme, si në kuadër të fletëvotimeve për kuvendet komunale, ashtu edhe në ato për kryetarë të komunave. 66,151 fletëvotime të pavlefshme për kuvendet komunale dhe 13,184 fletëvotime të pavlefshme për kryetarë të komunave, është bilanci i fletëvotimeve gjatë zgjedhjeve të 22 tetorit. Nëse këto statistika krahasohen me




Figura 1. Shtrirja votave të pavlefshme në zgjedhjet e fundit parlamentare 2017 në Kosovë

13 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. "Hulumtimi dhe analizimi i fletëvotimeve të pavlefshme për zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2014". Prishtinë: 2015. Fq. 5. Për më shumë, shih: http://www.kqz-ks.org/wp-content/uploads/2018/02/Raporti-i-hetimit-te-flv-2014_al-1.pdf

|||||

zgjedhjet lokale të vitit 2013, fletëvotimet e pavlefshme për kuvendet komunale kanë shënuar rënie prej 4,361 votash, ashtu si edhe ato për kryetarë të komunave, të cilat kanë shënuar rënie prej 1,668 votash.




Figura 2. Shtrirja votave të pavlefshme në zgjedhjet e fundit lokale për kuvendet komunale në Kosovë




Figura 3. Shtrirja votave të pavlefshme në zgjedhjet e fundit lokale për kryetarë të komunave në Kosovë

2.1.1 Shtrirja e votave të pavlefshme në zgjedhjet e përgjithshme, sipas komunave

Mesatarja e fletëvotimeve të pavlefshme në nivel vendi, për zgjedhjet e përgjithshme të mbajtura pas pavarësisë është rreth 4.5 për qind. Përqindja varion në komuna të ndryshme, gjatë zgjedhjeve të viteve të ndryshme.

Të ndara sipas komunave, në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2017, pesë komunat me përqindjen më të lartë të votave në raport me numrin e votuesve janë: Drenasi me 10.9 për qind, Skenderaj me 9.7 për qind, Novobërda me 7.8 për qind, Ranillugu me 7.4 për qind dhe Klina me 7.1 për qind. Kurse, komunat me përqindjen më të ulët të votave të pavlefshme në këto zgjedhje janë: Mamusha me 2.4 për qind, Prishtina me 3.8 për qind, Zveçani me 3.8 për qind, Klllokoti me 4 për qind dhe Juniku me 4.1 për qind.

Në zgjedhjet e vitit 2014, me përqindjen më të lartë të votave të pavlefshme prin Hani i Elezit me 7.6 për qind, e pasuar nga Ranillugu me 6.8 për qind, Shtërpca me 6.5 për qind, Shtimja me 6.3 për qind dhe Parteshi me 5.9 për qind. Renditja e komunave me përqindjen më të ulët të votave të pavlefshme mbetet pothuajse e njëjtë. Përqindjen më të ulët prej 2.5 për qind e ka sërish Mamusha. Pas saj, renditet Zveçani me 2.7 për qind, Prishtina me 2.8 për qind, Juniku me 3 për qind dhe Dragashi me 3.2 për qind.

Më 2010, kur u mbajtën zgjedhjet e para parlamentare pas shpalljes së pavarësisë, të cilat ishin kontestuar shkaku i parregullsive dhe mbarëvajtjes, si për rastësi kemi pasur numrin, respektivisht përqindjen më të ulët të votave të pavlefshme. Komuna ku është regjistruar përqindja më e lartë e votave të pavlefshme është Ranillugu me 8 për qind. Pas kësaj komune, Klllokoti (7.5 për qind), Mamusha (6.8 për qind), Skenderaj (5.9 për qind) dhe Mitrovica (5.7 për qind) janë komunat që përmbyllin listën e pesë komunave me më së shumti vota të pavlefshme. Në anën tjetër, komuna me më së paku fletëvotime të pavlefshme në zgjedhjet e vitit 2010 është Zveçani, komunë në të cilën nuk ishte evidentuar asnjë fletëvotim i pavlefshëm. Kjo, kryesisht si rezultat i bojkotimit të zgjedhjeve dhe pjesëmarrjes në shifra minimale (158 votues gjithsej) të popullatës së atjeshme. Përveç Zveçanit, komunat tjera me më së paku vota të pavlefshme janë Istogu me 2.6 për qind, Zubin Potoku me 3 për qind, Shtërpca me 3 për qind dhe Prishtina me 3 për qind po ashtu.

Renditjen e plotë të komunave, si dhe shtrirjen e fletëvotimeve të pavlefshme për zgjedhjet e përgjithshme, në secilën prej komunave mund ta gjeni në tabelën në vijim:

2.1.2 Shtrirja e votave të pavlefshme në zgjedhjet lokale për kuvendet komunale, sipas komunave

Siç u përmend paraprakisht, zgjedhjet e nivelit lokal, përkatësisht zgjedhjet për kuvendet komunale janë zgjedhjet ku deri më tani është prodhuar numri më i madh i fletëvotimeve të pavlefshme. Sipas raporteve të auditimit të fletëvotimeve nga ana e KQZ-së, ndër arsytet kryesore që qojnë në rritjen e fletëvotimeve të pavlefshme në krahasim me fletëvotimet për zgjedhjet e përgjithshme, është mungesa së fushatave adekuate për informim dhe edukim. Mirëpo, për nga natyra e pavlefshmërisë së fletëvotimeve, mbi 80 për qind e fletëvotimeve të pavlefshme janë shpallur të tilla si rezultat i shënjitimit të kandidatit por jo subjektit politik. Prandaj mund të thuhet se faktor tjetër esencial është rëndësia që subjektet politike i japin garës për kryetarë të komunave, duke lënë anash atë për kuvende komunale. Po ashtu, edhe fushatat e kandidatëve janë kryesisht të orientuara në dhënien e numrit të kandidatit, dhe shpeshherë duke anashkaluar mënyrën e shënjitimit të numrit të partisë. Mesatarja e fletëvotimeve të pavlefshme gjatë tri palë zgjedhjeve të fundit për kuvendet komunale është diku rreth 8 për qind, ndërsa ajo për kryetarë të komunave rreth 1.7 për qind. Për të krijuar një pasqyrë më të qartë të shtrirjes së fletëvotimeve të pavlefshme, në këtë pjesë do të ndahet shtrirja e fletëvotimeve të pavlefshme në zgjedhjet për kuvendet komunale dhe ato për kryetarë të komunave.

Nëse zgjedhjet për kuvendet komunale shihen nga rendi kronologjik i mbajtjes së tyre që nga shpallja e pavarësisë, atëherë zgjedhjet e vitit 2009 janë zgjedhjet me më së paku fletëvotime të pavlefshme, si për nga numri ashtu edhe nga përqindja e tyre. Në këto zgjedhje, Ferizaj është komuna me përqindjen më të lartë të votave të pavlefshme, me 11.4 për qind të tyre. Më tutje, Hani i Elezit është komuna e dytë për nga përqindja e lartë, komunë kjo në të cilën janë evidentuar nga 10.7 për qind vota të pavlefshme. Hani i Elezit pasohet nga Fushë Kosova me 10.6 për qind, Obiliqi me 10.5 për qind dhe Kamenica me 9.7 për qind të votave të pavlefshme. Kurse, nga pesë komunat me përqindjen më të ulët të fletëvotimeve të pavlefshme, katër janë nga komunat me shumicë serbe, në të cilat vlen të ceket që gjatë asaj kohe janë bojkotuar zgjedhjet, që ka ndikuar drejtpërdrejtë edhe në numrin aq të vogël të fletëvotimeve.

|||||



Figura 4. Shtrirja e votave të pavlefshme për zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë, sipas komunave

|||||

|||||



Figura 5. Shtrirja e votave të pavlefshme për zgjedhjet për kuvedet komunale në Kosovë, sipas komunave

|||||

Në Zveçan, vetëm 1 nga gjithsej 38 fletëvotimet ka qenë i pavlefshëm, që në përqindje i bie 2.6 për qind. Ngjashëm edhe në Leposaviq, janë evidentuar vetëm 4 fletëvotime të pavlefshme, apo 3.4 për qind. Pas këtyre dy komunave renditen Novobërda me 3.5 dhe Ranillugu me 3.9 për qind. Ndërsa, komuna me shumicë shqiptare që ka përqindjen më të ulët të fletëvotimeve është Skenderaj vetëm 3.9 për qind e fletëvotimeve kanë qenë të pavlefshme.

Përqindja më e lartë e fletëvotimeve të pavlefshme ndonjëherë, është ajo e zgjedhjeve lokale të vitit 2013, respektivisht e zgjedhjeve për kuvende komunale në të cilat rreth 70 mijë fletëvotime, apo 8.5 për qind e të gjitha fletëvotimeve janë shpallur të pavlefshme.

Drenasi është komuna me përqindjen më të lartë të fletëvotimeve të pavlefshme (11.6 për qind). Pas Drenasit renditen Vushtrria (10.8 për qind), Ferizaj (9.6 për qind), Vitia (9.6 për qind) dhe Kaçaniku (9.5 për qind). Ndërsa, në anën tjetër, komunat me përqindjen më të ulët të fletëvotimeve të pavlefshme janë Mamusha (4.6 për qind), Hani i Elezit (5.7 për qind), Ranillugu (5.8 për qind) dhe Dragashi (6 për qind).

Edhe në zgjedhjet e fundit të vitit 2017, sikur edhe në ato paraprake, komunat me shumicë serbe prijnë me shtrirjen e përqindjes më të lartë të votave të pavlefshme. Gjatë këtyre zgjedhjeve, përqindja e votave të pavlefshme në nivel vendi ishte rreth 8 për qind, që shënon një rënie të lehtë, në krahasim me zgjedhjet e vitit 2013. Katër nga pesë komunat me përqindjen më të lartë janë me shumicë serbe. Në këtë listë, prin Zubin Potoku me 12.3 për qind, pasuar nga Graçanica me 11.8 për qind, Drenasi me 11.2 për qind, Parteshi me 11 për qind, si dhe Zveçani me 10.9 për qind. Kurse, në fund të listës së komunave për nga përqindja e fletëvotimeve të pavlefshme, renditen Klllokoti me 5.9 për qind, Istogu me 5.8 për qind, Dragashi me 5.3 për qind, Juniku me 5 për qind, dhe Mamusha, që është komuna me numrin dhe përqindjen më të ulët të fletëvotimeve të pavlefshme, me vetëm 3.6 për qind.

2.1.3 Shtrirja e votave të pavlefshme në zgjedhjet lokale për kryetarë të komunave, sipas komunave

Në dallim nga zgjedhjet lokale për kuvendet komunale, me një mesatare prej rreth 1.7 për qind, zgjedhjet për kryetarë të komunave janë zgjedhjet ku është prodhuar numri dhe përqindja më e vogël e fletëvotimeve të pavlefshme në Kosovë. Nëse kësaj i shtohet fakti se një

numër i konsiderueshëm i këtyre fletëvotimeve, janë shpallur të pavlefshme për shkak se janë prishur qëllimisht nga votuesit, atëherë mund të konstatohet se kjo përqindje është në nivel krejtësisht të pranueshëm.

Në zgjedhjet e rregullta për kryetarë të komunave të vitit 2013, është shënuar numri dhe përqindja më e lartë e fletëvotimeve, me mbi 15 mijë vota, përkatësisht rreth 1.8 për qind, krahasuar me zgjedhjet e vitit 2017 ku ishin evidentuar rreth 14 mijë fletëvotime të pavlefshme, apo rreth 1.6 për qind, dhe zgjedhjet e vitit 2009, ku është shënuar numri më i vogël i fletëvotimeve, konkretisht rreth 11 mijë, apo rreth 1.5 për qind.

Ngjashëm sikur pothuajse në të gjitha zgjedhjet tjera, edhe në zgjedhjet e fundit për kryetarë të komunave në vitin 2017, komunat me shumicë serbe si dhe komunat nga rajoni i Drenicës kanë shënuar përqindjen më të lartë të fletëvotimeve të pavlefshme, për dallim nga komunat e mëdha, ku janë evidentuar dukshëm më pak vota të pavlefshme, në raport me numrin e përgjithshëm të fletëvotimeve. Komuna me përqindjen më të lartë të këtyre fletëvotimeve është Graçanica me 5.5 për qind. Graçanica pasohet nga Zubin Potoku me 4.7 për qind, Skenderaj me 4.6 për qind, Novobërda me 4.1 për qind dhe Drenasi me 2.9 për qind. Në anën tjetër, komuna me numrin dhe përqindjen e votave të pavlefshme, sikur edhe në zgjedhjet tjera, është Mamusha me vetëm 0.8 për qind të votave të pavlefshme. Pas Mamushës, renditen Peja me 0.9 për qind, Gjakova me 1.1 për qind, Prishtina me 1.2 për qind dhe Ferizaj me 1.8 për qind.

Trend i ngjashëm ishte shënuar në disa prej këtyre komunave edhe gjatë zgjedhjeve të vitit 2013. Në zgjedhjet e atij viti ishte Zveçani komuna e cila kishte përqindjen më të lartë të votave të pavlefshme, prej 4.8 për qind. Obiliqi (3.7 për qind), Drenasi (3.3 për qind), Skenderaj (3.2 për qind) dhe Klllokoti (3.2 për qind) përmbyllin listën e pesë komunave me përqindjen më të lartë të fletëvotimeve të pavlefshme. Kurse, për dallim nga zgjedhjet e fundit të vitit 2017, ku komunat me përqindjen më të ulët ishin kryesisht komunat e mëdha, në zgjedhjet e vitit 2013 ishin komunat e vogla ato që kishin përqindjen më të ulët, duke filluar nga Juniku me 0.7 për qind, Mamusha 0.8 për qind, Hani i Elezit me 0.8 për qind, Malisheva me 1 për qind, si dhe Shtërpca me 1 për qind.

Zveçani me 13.2 për qind, Zubin Potoku me 5.8 për qind, Drenasi me 5.3 për qind, Graçanica me 3.6 për qind dhe Leposaviqi me 2.7 për qind, janë pesë komunat me më së shumti vota të pavlefshme në zgjedhjet për kryetarë të komunave në vitin 2009.

Në ndërkohë, komunat me përqindjen më të ulët të fletëvotimeve të pavlefshme janë: Klokoti (0.6 për qind), Mamusha (0.8 për qind), Istogu (0.8 për qind), Gjakova

(0.9 për qind) dhe Suhareka (0.9 për qind). Lista e plotë e komunave me përqindjen e votave të pavlefshme është si në vijim:



Figura 6. Shtrirja e votave të pavlefshme për zgjedhjet për kryetarë të komunave në Kosovë, sipas komunave

2.2. Shtrirja e votave e pavlefshme në Evropë

Fenomeni i fletëvotimeve të pavlefshme nuk është i koncentruar në ndonjë zonë të caktuar gjeografike apo ndonjë rajon të globit. Ndonëse në përmasa dhe me natyrë të ndryshme, diku shumë më të shprehur e diku më pak, çdo shtet i cili organizon zgjedhje të lira dhe të drejta, ballafaqohet me një dukuri të tillë. Në këtë punim, janë pasqyruar të dhëna lidhur me votat e pavlefshme, përkatësisht shtrirjen e tyre në nivel të kontinentit të Evropës. Janë llogaritur votat e pavlefshme në zgjedhjet e fundit parlamentare të 37 shteteve. Mesatarja e votave të pavlefshme në nivel të këtyre shteteve është rreth 2.5 për qind. Në këtë listë, Kosova renditet si shteti i pestë me përqindjen më të lartë të fletëvotimeve të pavlefshme në zgjedhjet e fundit parlamentare.

Shteti me përqindjen më të lartë të votave të pavlefshme është Bosnje e Hercegovina me rreth 9 për qind. Kjo përqindje kaq e lartë i atribuohet kryesisht sistemit tejet të komplikuar të votimit, dhe votimit në nivele të ndryshme brenda një dite. Për të ofruar një pasqyrë të qartë mbi kompleksitetin e sistemit zgjedhor të Bosnje dhe Hercegovinës, në vijim do të ofrohen disa informata mbi të. Fillimisht, një nga problemet kryesore me zgjedhjet në Bosnje dhe Hercegovinë është se votuesve u ofrohet një numër shumë i madh i fletëvotimeve të ndryshme. Kjo për shkak se votuesit në Bosnje dhe Hercegovinë marrin fillimisht fletëvotimin për zgjedhjen e Presidentëve të Bosnje dhe Hercegovinës, fletëvotim ky i cili vlen të ceket se është i ndryshëm për të tri grupet e ndryshme etnike të Bosnje dhe Hercegovinës. Më tutje, votohet për përfaqësuesit në parlamentin e vendit, i cili sërish nuk është i njëjtë për të gjithë votuesit. Pastaj, vazhdohet me fletëvotimet për parlamentet e të dy entiteteve¹⁴, e që prej tyre, secila ka presidentin, zëvendës-presidentin, kryeministrin, deputetët dhe zyrtarët e tyre. Kurse, në rast se votuesit janë banorë të Federatës së Bosnje dhe Hercegovinës, ata votojnë po ashtu për nivelin kantonal, duke zgjedhur përfaqësuesit në parlamentet 'kantonale' për secilin nga 10 kantonet.

Pas Bosnjës renditen Luksemburgu me 6.8 për qind. Më tutje, Franca është shteti i tretë për nga përqindja e fletëvotimeve të pavlefshme, dhe shteti me numrin më të madh të fletëvotimeve, gjegjësisht mbi 2.5 milion sosh. Ndër arsyet kryesore për një numër dhe përqindje kaq të lartë të fletëvotimeve në Francë, përkundër faktit që listat zgjedhore janë të mbyllura, mund të konsiderohet numri i madh i zonave zgjedhore (577 zona zgjedhore), si dhe shpërndarja e tyre në territoret franceze, apo në kontinentet e tjera, ku niveli i edukimit dhe informimit të edukuesve lë shumë për të dëshiruar. Po ashtu, element tjetër crucial, i cili është përmendur pas zgjedhjeve të fundit të vitit 2017 në Francë, është edhe lënia e fletëvotimeve të zbrazëta si formë e shprehjes së pakënaqësisë, si dhe akuzave të partive të caktuara politike që një pjesë e fletëvotimeve janë prishur qëllimisht nga kundërshtarët politik¹⁵. Belgjika është shteti i katërt ku janë evidentuar rreth gjysmë milioni fletëvotimeve të pavlefshme, apo rreth 5.7 për qind të numrit të përgjithshëm të fletëvotimeve. Në anën tjetër, shteti me përqindjen më të ulët të fletëvotimeve të pavlefshme është Mbretëria e Bashkuar me vetëm 0.23 për qind.

Në mesin e shteteve të Ballkanit Perëndimor, Bosnje e Hercegovina dhe Kosova mbështin shtetet me përqindjen më të lartë të fletëvotimeve të pavlefshme. Kurse pas tyre, renditen Maqedonia me rreth 3.2 për qind, Serbia me rreth 2.9 për qind, Shqipëria me rreth 2 për qind, si dhe Mali i Zi me vetëm rreth 1.4 për qind të fletëvotimeve të pavlefshme.

Nëse merren parasysh specifikat e sistemeve zgjedhore të këtyre 37 vendeve, përkatësisht kompleksiteti i tyre, atëherë mund të konkludohet se numri i votave të pavlefshme nuk është direkt i lidhur me listat zgjedhore, numrin e zonave zgjedhore apo karakteristikat e tjera. Faktorët kyç në këtë drejtim janë niveli i edukimit të votuesve, përkatësisht fushatat për informim dhe edukim, si dhe niveli i kënaqshmërisë me performancën e partive politike. Kjo pasi që, në shumicën e këtyre vendeve, pjesa dërmuese e fletëvotimeve të pavlefshme, janë shpallur si të tilla pasi që janë lënë të zbrazëta ose janë prishur qëllimisht nga votuesit, si formë e shprehjes së kundërshtimit apo abstënimit nga procesi zgjedhor.

14 Bosnja dhe Hercegovina është e ndarë në dy entitete: Federatën e Bosnje dhe Hercegovinës dhe Republikën Serbe.

15 "French Election: Protest Vote for 'Nobody' Was Highest In Half a Century". NBC News. 2017
Për më shumë, shih: <https://www.nbcnews.com/news/world/french-election-protest-vote-nobody-was-highest-half-century-n756261>
(qasur më 2 tetor, 2018)

|||||




Figura 7. Shtrirja e votave të pavlefshme në zgjedhjet e fundit parlamentare të vendeve të Evropës

|||||

3

FUSHATAT PËR INFORMIM DHE EDUKIM TË VOTUESVE NË DY PALË ZGJEDHJET E FUNDIT NË KOSOVË

- 32** 3.1 Zgjedhjet në Kosovë – përvoja e deritanishme e Fushatës së Informimit të Publikut
- 34** 3.2 Infrastruktura ligjore dhe Strategjia për Informim të Publikut
- 36** 3.3 Analizë kritike e aspektit profesional të fushatave informuese
- 36** 3.4 Krahasimet dhe Përvojat e Malit të Zi dhe Kroacisë



3. FUSHATAT PËR INFORMIM DHE EDUKIM TË VOTUESVE NË DY PALË ZGJEDHJET E FUNDIT NË KOSOVË

Përkundër faktit se janë zhvilluar shumë cikle zgjedhore, pas të cilave është thënë se janë zgjedhjet më të mira të organizuara ndonjëherë, sfidat pothuajse të njëjta mbesin dhe përsëriten nga njëra palë zgjedhesh në tjetrën. Një nga këto sfida për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve është organizimi i mirëfilltë i Fushatës së Informimit Publik (FIP) për edukimin e votuesve.

Në një aspekt tjetër, nëse jo përfundimisht – një fushatë profesionale e Informimit Publik (FIP) do të kontribuonte në krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për zgjedhje të lira dhe demokratike, që mbështetet në vendimet e elektoratit të mirë-informuar për rëndësinë e pjesëmarrjes në zgjedhje, të drejtat e tyre, të drejtën e votës e deri tek mënyra e votimit. Prandaj, krahas sfidave të mëdha të KQZ-së për organizimin e zgjedhjeve të lira e demokratike, përgatitjen profesionale dhe krijimit të hapësirës së përshtatshme për të gjitha subjektet dhe kandidatët që garojnë në zgjedhje, është edhe aspekti i planifikimit dhe ekzekutimit të Fushatës së Informimit të Publikut.

Mbi të gjitha, KQZ-ja jo vetëm që siguron kushte për një fushatë të balancuar dhe fer në raport me të gjitha partitë politike që garojnë, por ajo duhet të marrë rol pro aktiv që t'ia sigurojë elektoratit informatat e shumta dhe të nevojshme për pjesëmarrje aktive në zgjedhje, si një nga shtyllat kryesore të demokracisë moderne. Mungesa e fushatave të mirëfillta, që përcillen drejtpërdrejt me informacione të pakta për mënyrën e votimit, e cila shpesh vjen nga kultura politike e shtetërore, traditat, rregullimi

ligjor dhe vet-rregullimi, kanë ndikim cilësor të drejtpërdrejt në rezultatet dhe të zgjedhurit që do të qeverisin.

Ky kapitull ka për qëllim të analizojë në mënyrë kritike zgjedhjet e fundit lokale dhe të përgjithshme, në kontekstin e organizimit të fushatës së Informimit Publik, duke u përqendruar në infrastrukturën ligjore dhe rregulloret e brendshme, si dhe të analizojë strategjinë e brendshme të KQZ-së për informim të publikut. Po ashtu, analiza ka për synim të ndalet më në detaje për përgatitjen profesionale të fushatave informuese të KQZ-së, përqindjen aspak të balancuar të transmetimit në media të reklamave për votuesit krahasuar me ato të partive politike, si dhe aspektin audio-vizual të dizajnit, mesazheve që përcillen e deri tek rrethanat teknike të një fushate.

Së pari, gjetjet e KQZ-së, janë alarmante për nga numri i madh i fletëvotimeve të pavlefshme. Ato tërthorazi janë rezultat i pamundësisë së arritjes së mesazheve të duhura dhe në kohë të KQZ-së për mënyrën e votimit. Në raportet e KQZ-së për hetimin e fletëvotimeve të pavlefshme, sugjerohet si një nga rekomandimet kryesore që të dizajnohet një fushatë e veçantë informimi për t'i eliminuar këto raste. Nga gjetjet e tjera, po ashtu arrihet në përfundim se fushata e informimit nuk ka të bëjë vetëm me votuesit, por edhe me anëtarët e angazhuar në ditën e zgjedhjeve të cilët për mungesë të përgatitjeve dhe trajnimeve të duhura bëjnë shumë lëshime.

Aspekt i dytë është karakteri profesional i fushatës së Informimit Publik ku gjetjet kryesisht rezultojnë me





mungesën e kreativitetit sa i përket përmbajtjes, përdorimin e një shablloni të fushatës për të gjitha audienat, mungesë hartimi të mesazheve për grupet e synuara sa i përket moshës, rajonit prej nga vijnë votuesit dhe përkatësisë etnike, përdorimit të aktorëve profesional në video/radio-reklama dhe jo votuesve të vërtetë për t'i përçuar mesazhet, si dhe mungesa e duhur e trajnimeve dhe hartimit të doracakëve në mënyrë sa më të thjeshtë.

Prandaj, nisur nga këto të gjetje, analiza do të fokusohet drejtpërdrejt në diskutimin e rrethanave që kanë ndikuar në cilësi të dobët të fushatave të informimit publik, duke prodhuar rrjedhimisht një numër të madh të fletëvotimeve të pavlefshme. Mbetet detyrë jo vetëm e KQZ-së, si institucioni që në bazë të Kushtetutës e ka mandatin t'i organizoj zgjedhjet, por edhe aktorëve të tjerë qoftë të shoqërisë civile, mediave dhe partive që të angazhohen për të krijuar një mjedis që çdo qytetar, pavarësisht moshës, përkatësisë dhe nivelit të edukimit, brenda apo jashtë Kosovës, të jetë i informuar për rëndësinë e pjesëmarrjes në zgjedhje dhe mënyrën e votimit. Është përgjegjësi jo vetëm ligjore, por edhe qytetare për të siguruar që vullneti i qytetarëve është përkthyer si duhet dhe jo si pasojë e një informacioni të munguar.

Nisur nga nevoja për t'i paraprirë një procesi të mirëfilltë të organizimit të zgjedhjeve dhe informimit më të mirë të votuesve si dhe pjesëtarëve që marrin pjesë në organizimin e zgjedhjeve, KDI-ja do të listojë një sërë rekomandimesh se çfarë duhet ndërmarrë KQZ-ja për të përmirësuar dukshëm fushatat sa i përket aspektit profesional, dhe rrjedhimisht t'i minimizojë gabimet gjatë votimit, sikurse edhe të nxisë sa më shumë votues të marrin pjesë në procesin zgjedhor. Po ashtu, kjo analizë ka hulumtuar dhe krahasuar përvojat e të paktën dy vendeve në rajon, Malit të Zi, si kandidat për anëtarësim në BE dhe Kroacisë, vend anëtar i BE-së. Nga të gjeturat, rezulton se përvojat dhe rrethanat janë të tjera, dhe Fushata e Informimit Publik në Kosovë duhet t'i përshtatet nevojave dhe kontekstit kosovar.

Për hartimin e kësaj analize është aplikuar një metodologji e kombinuar e cila ndahet përfshin tri aspekte:

- a) Metoda kualitative përmes aranzhimit të intervistave me aktorë të përfshirë drejtpërdrejtë në organizimin e zgjedhjeve, të fushatave, të cilët kanë udhëhequr procesin e informimit dhe monitorimit të zgjedhjeve;
- b) 'Desk research' – që është mbështetur në një hulumtim të thellë të raporteve dhe krahasimit të tyre, artikujve të ndryshëm në media për fushatat e kaluara, si

dhe të gjeturave të tjera nga organizatat vendore dhe ndërkombëtare të monitorimit të zgjedhjeve;

- c) Një hulumtim dhe analizë kritike sa i përket vetë përmbajtjes së Strategjisë për Informimin e Publikut dhe aspektit profesional të fushatave të fundit.

3.1 Zgjedhjet në Kosovë – përvoja e deritanishme e Fushatës së Informimit të Publikut

Organizimi para kohe i zgjedhjeve të fundit të përgjithshme në Kosovë, si dhe urgjenca për të kryer përgatitjet teknike me shpejtësi, janë shoqëruar edhe me mangësi. Një nga gjetjet që i ka përcjellë këto zgjedhje është mungesa e një fushate informuese cilësore për edukimin e votuesve, të drejtat e tyre dhe mënyrën e votimit. Si rezultat, procesi zgjedhor ka rezultuar me një numër të madh të fletëvotimeve të pavlefshme. Jo vetëm kaq, gjetjet flasin për një fushatë të organizuar shpejt dhe lirë, pa ndonjë përmbajtje të duhur profesionale që ngatërron mesazhin për audiencën e duhur dhe mbidominohet nga mesazhet politike të subjekteve politike. Këto mangësi të theksuara të përgatitjes profesionale të fushatave, që vijnë edhe si rezultat i kohës së shkurtër në dispozicion, përzgjedhja e të njëjtës kompani PR-i në vazhdimësi nga ana e KQZ-së, e deri tek përdorimi i aktorëve në reklamat e vetëdijesimit, ka prodhuar mungesë të theksuar të rezultateve të pritura.

Nga ana tjetër, në një hulumtim të opinionit publik, të cilin KDI-ja e ka zhvilluar në shtator të vitit 2018, vetëm 27.3 për qind e respondentëve kanë deklaruar se janë informuar nëpërmjet fushatës informuese të KQZ-së sa i përket procedurave dhe mënyrës së votimit në zgjedhjet e fundit. Kurse 30.5 për qind e të anketuarve e kanë vlerësuar si shumë të dobishme fushatën e KQZ-së për informimin dhe edukimin e votuesve. Disa nga bartësit e institucioneve për organizimin e zgjedhjeve, me të cilët KDI-ja ka zhvilluar takime, e pranojnë pamundësinë e KQZ-së për të organizuar një fushatë të mirëfilltë informimi të votuesve.

Enis Halimi, Kryeshef Ekzekutiv i KQZ-së thotë se: "organizimi i parakohshëm i zgjedhjeve dhe përgatitja e tyre në një afat rekord ka ndikuar për të keq në informimin e votuesit meqë ishte e pamundur të udhëhiqej një proces normal i përgatitjes profesionale të fushatës. Gjithçka bëhej me shpejtësi". Sipas tij, janë edhe mekanizmat ligjor të tenderimit dhe prokurimit, të përzgjedhjes së kompanisë përgjegjëse për fushatën që krijojnë një disavantazh qysh



në fillim. Ai pohon se: "shpesh rastis që në bazë të ligjit në fuqi ta fitojë tenderin ndonjë kompani që nuk shumë përvojë as dije por e ofron ofertën me çmim të ulët"¹⁶. Pra, procedurat e prokurimit, koha e shkurtër e realizimit, ndonjëherë më pak se 48 orë në dispozicion për 12 TV spote, sipas Azemine Beqirit, përgjegjëse për komunikim në KQZ, ndikon në prodhimin e fushatës dhe komunikimit që është larg pritjeve profesionale¹⁷. Kjo zyrtare, e cila merret drejtpërdrejt me këtë komponentë në KQZ, thotë se: "derisa të përzgjidhet kompania ekziston njëfarë interesi brenda institucionit që të përmbushet kërkesa ligjore tenderuese por pastaj punët zakonisht duhet të kryhen shpejt dhe në kohë rekorde". Sipas Beqirit, në raste kur Këshilli për Informim Publik, i cili vlerëson produktet e ofruara nga kompanitë, ka më shumë komoditet me kohën, ndodhë që produktet të kthehen mbrapshtë për t'u përmirësuar. Por, rezulton se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve deri tani nuk ka bërë kurrfarë analize për mbarëvajtjen e këtyre fushatave, ndër të tjera edhe për shkak të mungesës së buxhetit. Megjithatë, KQZ-ja ka në plan që për herë të parë, në vitin 2019 të bëjë një analizë të detajuar për qasjen, mangësitë dhe përparësitë e fushatës së saj të informimit publik. Të

gjithë zyrtarët që ka biseduar KDI-ja, janë të mendimit se fushata e Informimit Publik të Votuesve duhet të jetë po aq e rëndësishme dhe prioritet sikur edhe aspektet e tjera të organizimit të zgjedhjeve në tërë territorin e Kosovës. Kjo argumentohet sipas tyre, me faktin se KQZ-ja më shumë fokusohet në organizimin teknik dhe kushtetues të zgjedhjeve prej përmbushjes së afateve ligjore, hartimit e shpërndarjes së fletëvotimeve, përpilimit të listës komisionerëve e kërkesave të tjera sesa informimit publik.

Po ashtu, KQZ-ja me buxhetin e ndarë për FIP-i asnjëherë nuk ka mundur të prodhojë kualitet më shumë në fushatën e edukimit të votuesit. Rrjedhimisht, njerëzit më pak kanë besuar sepse nuk është krijuar ndonjë lidhje e mundshme emocionale. Kjo për dallim nga partitë politike, të cilat e dominojnë hapësirën me mesazhe të paguara gjatë kohës së fushatës. Është një dallim shumë i madh në kreativitet dhe aspektin profesional. Një raport i monitoruesve evropian për zgjedhjet e fundit më 2017 në Kosovë nxjerr shifra alarmante për përqindjen e rezervuar në media për mesazhet e paguara të partive për votuesit dhe në anën tjetër, edukimin e votuesve.




Figura 8. Hapësira që televizionet kryesore në Kosovë u kanë kushtuar materialeve të partive dhe tyre për informimin e publikut, sipas monitorimit të misionit të BE-së*

¹⁶ Halimi, Enis. Intervistë personale, Shtator 2018

¹⁷ Beqiri, Azemine, Intervistë personale, Shtator 2018

Madje, për dallim nga KQZ-ja, edhe partitë e vogla gati të papërfillshme, arrijnë të komunikojnë në forma të ndryshme me votuesit e tyre qoftë përmes mediave apo fizikisht. Deri tani, KQZ-ja kryesisht ka organizuar fushata në mediat tradicionale, dhe deri diku ato sociale, por jo sa duhet drejtpërdrejt me votuesit në terren.

Monitoruesit evropian megjithëse e përgëzojnë KQZ-në për përmirësimin në edukimin e votuesit gjatë zgjedhjeve të fundit, flasin për sfidat të tjera që nuk janë rregulluar ende ligjërisht sa i përket pa kufizimit të partive politike për hapësirën e blerë në media.¹⁸ Ndaj sipas argumenteve të tyre është krijuar një hapësirë krejtësisht e pabarabartë e prezantimit të partive dhe të KQZ-së në media.

“Provizionet e paqarta ligjore i kanë lejuar pjesëmarrësit në zgjedhje që të marrin mbulim të sponsorizuar, si shtesë nga reklamimi i paguar politik i rregulluar me ligj. Kjo ka bërë që disa kanale televizive të ofrojnë program të zgjeruar të paguar, në dallim prej mbulimi editorial, e që ndikon në informimin e drejtë të votuesve. Komisioni i Pavarur i Mediave nuk i ka adresuar në mënyrë efektive shkeljet që mediat kanë bërë gjatë fushatës zgjedhore”¹⁹. Jo vetëm kaq, edhe NDI-ja, e cila i referohet gjetjeve të rrjetit të monitoruesve vendor “Demokracia në Veprim”, e ka kritikuar KQZ-në për mungesë të edukimit të votuesve. Megjithëse zyrtarët e KQZ-së janë arsyetuar për mungesë të kohës së mjaftueshme, DV-jaka kërkuar që të punohet shumë më herët dhe të mbështetet në strategji të mirëfillta komunikimi.²⁰

3.2 Infrastruktura ligjore dhe Strategjia për Informim të Publikut

Strategjia për Informim Publik është një dokument i brendshëm disa faqesh i KQZ-së, e cila në mënyrë të përgjithshme rregullon bazën e informimit publik gjatë zgjedhjeve. Në këtë dokument, flitet për qëllimet e

fushatës, pritjet dhe objektivat të cilat janë të shumta dhe mjaft ambicioze për t'u implementuar në një periudhë të shkurtër kohore sikurse parashihet me Ligjin për Zgjedhje. Sipas Strategjisë, KQZ-ja është “gjithashtu përgjegjëse edhe për informimin e palëve tjera të interesuara për zgjedhje sikurse subjektet politike, organizatat e shoqërisë civile dhe mediat lidhur me aktivitetet zgjedhore në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe në kohën e duhur”²¹.

Objektivat e strategjisë janë dhënia e informatave për procesin zgjedhor votuesve dhe subjekteve politike; informimi i votuesve për të drejtat e tyre; informimi për edukimin; për mënyrën e votimit dhe për rritjen e pjesëmarrjes në zgjedhje. Po ashtu, një nga objektivat e parafundit është për zvogëlimin e numrit të fletëvotimeve të pavlefshme. Pa analizuar objektivat e tjera të strategjisë, të cilat nuk mund të përbushen në disa javë fushatë, fokusi do të jetë tek objektivat që ndërlidhen me edukimin e votuesve dhe zvogëlimin e numrit të fletëvotimeve të pavlefshme.



Provizionet e paqarta ligjore i kanë lejuar pjesëmarrësit në zgjedhje që të marrin mbulim të sponsorizuar, si shtesë nga reklamimi i paguar politik i rregulluar me ligj. Kjo ka bërë që disa kanale televizive të ofrojnë program të zgjeruar të paguar, në dallim prej mbulimi editorial, e që ndikon në informimin e drejtë të votuesve.

Komisioni i Pavarur i Mediave nuk i ka adresuar në mënyrë efektive shkeljet që mediat kanë bërë gjatë fushatës zgjedhore



18 European Union Election Observation Mission (EUEOM). “Two faces of Kosovo municipal elections”. Prishtinë: 2017. Për më shumë, shih: https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/ps_final_formatted.pdf

19 Po aty.

20 National Democratic Institute Kosovo (NDI). “Kosovo’s June 2017 Parliamentary Elections”. Prishtinë: 2017. Për më shumë, shih: https://www.ndi.org/sites/default/files/NDI%20Kosovo%20June%202017%20Election%20Report_0.pdf

21 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. “Strategjia për Informim të Publikut”. Prishtinë: 2017. Fq.3

Po në këtë dokument, përshkruhen edhe grupet e synuara, pritjet e zbatimit të strategjisë, mjetet që synohen të përdoren sikurse mediat tradicionale dhe ato sociale, e deri tek komunikimi i drejtpërdrejt i zyrtarëve të KQZ-së përmes konferencave për media dhe intervistave. Po ashtu, KQZ-ja parasheh sipas dokumentit, të shpërndaj grupe mobile dhe të organizojë tubime në zona rurale e nëpër shkolla të mesme për të informuar votuesit më në nevojë. Në pjesën e fundit të dokumentit, përmendet një listë produktesh, të cilat duhet të dizajnohen, prodhohen dhe shpërndahen në të gjithë Kosovën për grupet e synuara.

Nga kjo perspektivë, dokumenti është një udhërrëfyes i mirë për ta mbajtur të fokusuar KQZ-në ndaj obligimeve të saj kushtetuese e ligjore. Por aktivitetet që parashihen të përmbushen është gati e pamundshme të zbatohen. Kjo nga fakti se periudha kohore është shumë e shkurtër, ndaj kërkohet një buxhet i madh dhe një ekip profesionistësh që duhet ngritur brenda KQZ-së për ta udhëhequr 24 orë procesin e Informimit të Publikut. Tek disa aktivitete që parashihen në dokument, nuk tregohen rrugët dhe strategjitë si do të përmbushen, sikurse bie fjala tek pjesa e bashkëpunimit me organizatat dhe institucionet. Po ashtu, përmenden të përdoren në mënyrë aktive mediat sociale sikurse Facebook, Instagram, Twitter dhe Youtube, ndërsa nga një hulumtim i shkurtër vërehet se ato nuk janë fare të përditësuara dhe nuk gjenerojnë kurrfarë komunikimi të dyanshëm me votuesit. Pra, ekziston një shpërndarje e madhe e aktiviteteve të komunikimit nga zgjedhjet në zgjedhje. Duke u nisur nga kjo situatë, KQZ-ja duhet të instalojë "konceptin e komunikimit të menaxhimit të përhershëm të fushatës dhe pikërisht të aktivizohet për disa aspekte në kohë kur nuk ka zgjedhje".

Një aspekt i fundit i strategjisë që ndërlihet me produktet dhe konceptin është se KQZ-ja nuk e orienton kompaninë gjatë fazës së tenderimit për aspektet përmbajtësore dhe pritjet që ka. Kryesisht, mbështetet në propozimet e kompanisë pas përzgjedhjes, që në të shumtën e rasteve rezultojnë aspak profesionale.

Nisur nga kjo gjendje aktuale, KDI-ja konsideron se dokumenti strategjik duhet të theksojë qartë objektivat dhe pritjet që kërkohen prej kompanisë së përzgjedhur për ta dizajnuar dhe implementuar fushatën. Nëse ka nevojë, kërkohet që të ketë një riorganizim të brendshëm institucional e ligjor që të sigurohet një fushatë kredibile që nuk zhvillohet vetëm gjatë kohës së zgjedhjeve

por shumë muaj para se të nisë fushatën. Shpesh herë, në mediat e vendit hasen edhe fushata të tjera që bëjnë thirrje për votë dhe i edukojnë votuesit, e që nuk dihet a janë nga KQZ-ja, nga partitë politike apo nga ndonjë organizatë jo qeveritare. Të tilla ka pasur në vazhdimësi, duke krijuar edhe një lloj kakofonie te votuesit. Ekspertët e komunikimit sugjerojnë që "të punohet në përmbajtje, dizajne tërheqëse të materialeve të fushatës që arrijnë të ndikojnë votuesit". Veçmas reklamat e KQZ-së duhet të dallohen sepse qytetarët shpesh mendojnë që janë nga ndonjë subjekt politik dhe nuk u kushtojnë vëmendje.

Po ashtu, KQZ-ja duhet të përfshijë në strategjinë e komunikimit kërkesa specifike, të ngris një mekanizëm profesional të mbikëqyrjes dhe që fushata të ndahet në disa faza.

- E para, të ketë mesazhe të thjeshta me thirrje për pjesëmarrje sa më të madhe në votime. Një kërkesë kjo demokratike për ta përmbushur si shoqëri,
- Së dyti, të komunikohet mënyra si votohet - veçmas duke theksuar rëndësinë e votimit fillimisht për partinë, e pastaj për kandidatin. Nga të dhënat, rezultoni se këtu ndodhë një numër i madh i gabimeve dhe për rrjedhojë ka numër të madh të fletëvotimeve të pavlefshme, dhe
- Së treti, në zona banimi me shumë fletëvotime të pavlefshme duhet që KQZ të përdor mjete të tjera përveç komunikimit audio-vizual të fushatës. Duhet të simulohet dhe ofroj mënyra të votimit dhe trajnime specifike si duhet votuar. Po ashtu, duhet të dërgojë ekupe vullnetarësh për të punuar në mënyrë më intensive me këto kategori të njerëzve.

Megjithatë, ka një zhvillim pozitiv nga ana e KQZ-së meqë ajo po planifikon që ta ndryshoj praktikën e deritanishme ku gjithçka sa i përket fushatës i është besuar kompanisë. Madje ajo ka qenë përgjegjëse duke vendosur për media planin, dhe mënyrën e shpërndarjes së transmetimeve të reklamave në TV. Ka pasur vetëm një lloj mbikëqyrje formale por aspak e detajuar. Tani e tutje, KQZ-ja planifikon që vetë ta hartoj planin e shpërndarjes së reklamave dhe të merret me shpërndarjen e tyre nëpër media. Po ashtu, synohet që zyrtarë të KQZ-së të jenë edhe vetë më të pranishëm në media duke mos ua lënë krejt hapësirën publike partive politike. Ideja e strategjisë si dokument i brendshëm është shumë e qëlluar, por duhet të plotësohet në përmbajtje, ide dhe të ketë një plan kohor të implementimit.

3.3 Analizë kritike e aspektit profesional të fushatave informuese

KQZ-ja në çdo palë zgjedhje e udhëheq fushatën e informimit të publikut. Ideja, koncepti dhe fryma e fushatës propozohet kryesisht nga kompania që e fiton tenderin dhe nuk është domosdoshmërisht kërkesë e KQZ-së. Megjithatë, duhet pranuar se organizimi i zgjedhjeve të parakohshme dhe të jashtëzakonshme për KQZ-në ka krijuar shumë vështirësi në përgatitjen e një fushate të mirëfilltë profesionale. Por, situata nuk është më e mirë as me fushatat në kohë zgjedhjesh të rregullta. Sërish ka numër të madh të fletëvotimeve të pavlefshme. Për t'i evituar këto të meta, dhe me qëllim të përballimit më të lehtë të zgjedhjeve të parakohshme, KQZ-ja duhet të ndjekë një qasje pro aktive duke bërë fushatë të vazhdueshme në grupe të mbyllura në zonat ku ka më shumë vota të pavlefshme.

Nëse analizohet më konkretisht fushata e informimit publik, produktet si reklamat dhe mesazhet, gjuha e tyre e deri tek dizajni, ka një numër të madh të metash që thuajse fare pak përçojnë mesazhe të duhura tek votuesi. Audienca është përzgjedhur jo si duhet. Kryesisht përdoren aktorë/ humoristë në të gjitha reklamat dhe e njëjta vetëm përkthehet për votuesit e komuniteteve të tjera.

Kjo prodhon një mos interesim të votuesve jo shqiptar, sepse ata presin në shohin në reklama njerëz me të cilët mund të identifikohen. Reklamat janë shumë të gjata dhe krijojnë mjaft vështirësi për t'u ndjekur deri në fund nga votuesit. Grafikët që përdoren për ta shpjeguar mënyrën e votimit, në shumicën e reklamave janë të gjata dhe nuk e mbajnë fokusin e duhur tek votuesi. Nga një monitorim i shpejtë i mediave, rezultoi se shumica e këtyre reklamave nuk janë transmetuar në pikun e kohës (prime time), por në afate kohore të papërfillshme.

Nga gjetjet, analizat dhe intervistat, KDI-ja rekomandon një listë të udhëzimeve si duhet përmirësuar infrastruktura ligjore, plotësuar dokumenti i strategjitë e deri tek aspektet teknike, profesionale të fushatës dhe dizajnit.

3.4 Krahasimet dhe Përvojat e Malit të Zi dhe Kroacisë

Mali i Zi, ka organizuar një sërë zgjedhjesh që prej shpalljes së pavarësisë nga Serbia në vitin 2006. Ky shtet organizon zgjedhje parlamentare me një zonë të vetme zgjedhore, për të zgjedhur 81 deputetë, dhe zgjedhje të drejtpërdrejta presidenciale, në dy runde, nëse në të parin njëri kandidat nuk i fiton më shumë se gjysmën e votave. Komisioni Shtetëror Zgjedhor, siç quhet organi që i organizon zgjedhjet në Malin e Zi, përgatitë një sërë fushatash në përpjekje



Figura 9. Mesazhi motivues për të rinj, me origjinalin në shqip, por i modifikuar në montazh në disa gjuhë – 2017

Rrjedhimisht , kandidatët që kishin më shumë mjete, morën më shumë hapësirë dhe kishin përparësi

|||||

në çmimet e tyre të zakonshme, gjë që sfidoi kërkesat ligjore për kushte të barabarta ndërmjet kandidatëve. Rrjedhimisht, kandidatët që kishin më shumë mjete, morën më shumë hapësirë dhe kishin përparësi”²³.

Përkundër organizimit të suksesshëm të zgjedhjeve, KSHZ-ja në Mal të Zi është një institucion që vazhdimisht ka pasur përplasje me forca të ndryshme politike. Në dy palë zgjedhjet e fundit 2016-2018 është shquar për mostransparencë, për shkak të mbajtjes së mbledhjeve larg mediave, dhe mospublikimit të të gjitha vendimeve të veta në uebfaqen e saj në internet. KQZ-ja e Kosovës në këtë drejtim është kampione e transparencës dhe e mënyrës së organizimit të zgjedhjeve.

Edhe në vendet e tjera, sikurse në Kroaci, vend anëtar i BE-së, ka një përvojë tjetër specifike që e dallon nga Kosova. Fushatat e vetëdijesimit pothuajse nuk ekzistojnë fare, por Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve në këtë vend kujdeset që të nxjerrë sa më herët rregulloret që përcaktojnë mbarëvajtjen e zgjedhjeve; kufizimet; të drejtat e deri tek afatet – njoftime këto që botohet në uebfaqen zyrtare të institucionit. Kjo edhe për faktin se Kroacia, nuk e ka problemin me të cilin përballlet Kosova. Po ashtu, Komisioni organizon disa lloj zgjedhjesh, përfshirë edhe ato për Parlament Evropian, ndaj gjatë gjithë vitit është aktiv. Kujdesi më i madh është informimi me kohë dhe nxjerrja e rregullave të nevojshme për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor sa më demokratik.²⁴

23 Office for Democratic Institutions and Human Rights (OSCE – ODIHR). “Montenegro Presidential Elections 15 April 2018”. Varshavë: 2018. Për më shumë, shih: <https://www.osce.org/odihr/elections/montenegro/386127?download=true>

24 Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve në Kroaci: “Përdorimi i sistemit të votimit elektronik”. Zagreb: 2018. Për më shumë, shih: https://www.izbori.hr/site/UserDocs/Images/priopcenja/2018_priopcenje_elektronicko_glasovanje.pdf

|||||

4

RAPORTI I HULUMTIMIT TË OPINIONIT PUBLIK “REFORMA ZGJEDHORE DHE VOTAT E PAVLEFSHME NË KOSOVË”

- 41** 4.1 Perceptimet e përgjithshme qytetare mbi situatën politike
- 42** 4.2 Pjesëmarrja e votuesve në dy proceset e kaluara zgjedhore
- 45** 4.3 Çfarë sistemi zgjedhor preferojnë qytetarët e Kosovës
- 48** 4.4 Testimi i dizajnit të ri të fletëvotimit për zgjedhjet e përgjithshme



4. RAPORTI I HULUMTIMIT TË OPINIONIT PUBLIK "REFORMA ZGJEDHORE DHE VOTAT E PAVLEFSHME NË KOSOVË"

Me qëllim të marrjes edhe të perspektivës qytetare lidhur me situatën politike, nivelin e llogaridhënies së deputetëve, dhe në veçanti të preferencave të tyre lidhur me sistemin zgjedhor që duhet ta ketë Kosova, KDI-ja ka zhvilluar një hulumtim të opinionit publik gjatë periudhës 25 gusht – 5 shtator të vitit 2018. Sa i përket metodologjisë hulumtuese, është përzgjedhur tipi kuantitativ i hulumtimit, përkatësisht intervistat ballë për ballë nëpër shtëpi. Hulumtimi ka përfshirë 1,200 të anketuar, duke pasur parasysh mostrën përfaqësuese të Kosovës dhe të drejtën e pjesëmarrjes në zgjedhje, që është mbi moshën 18 vjeç. Nga të gjithë të anketuarit, 49.5 për qind janë burra, ndërsa 50.5 për qind janë gra. Për të siguruar përfaqësimin e popullsisë në bazë të përkatësisë etnike, 70.8 për qind e të anketuarave kanë qenë shqiptarë, 16.7 për qind serbë dhe 12.5 për qind nga komunitetet tjera jo-shumicë. Për të garantuar përfshirje të të anketuarve edhe në bazë të vendbanimit, 54 për qind e tyre kanë qenë nga zonat rurale dhe 46 për qind nga zonat urbane. Shkalla e gabimit është +/- 2.74 për qind.

- I. Pyetësi ka përmbajtur afër 40 pyetje dhe është ndarë në katër seksione të ndryshme;
- II. Vlerësimi i përgjithshëm qytetarë për zhvillimet e përgjithshme politike;
- III. Pjesëmarrja dhe arsyet e votimit në zgjedhje;
- IV. Perceptimet rreth reformës zgjedhore dhe fushatës për edukim dhe informim të votuesve;
- V. Testimi fizik i 1,200 fletëvotimeve të reja të dizajnuara nga KDI me qëllim të përmirësimit të sistemit zgjedhor dhe uljes së votave të pavlefshme.

4.1 Perceptimet e përgjithshme qytetare mbi situatën politike

Hulumtimi është zhvilluar në periudhën kur është bërë një vit nga konsolidimi i institucioneve të dala nga zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare të mbajtura më 11 qershor 2018. Për këtë shkak, pyetjet fillestare të anketës kanë përfshirë çështje që kanë të bëjnë me perceptimin e përgjithshëm qytetar, sa i përket situatës politike në Kosovë dhe zhvillimeve politike si dhe punën e qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës 1 vit pas konsolidimit të tyre.

Në pyetjen se si e vlerësojnë drejtimin e zhvillimeve në vend, pjesa dërmuese e tyre (rreth 74 për qind), mendojnë se gjërat në Kosovë janë duke shkuar në drejtimin e gabuar, ndërsa vetëm 20 për qind e të anketuarve mendojnë se gjërat janë duke shkuar në drejtimin e duhur. Kjo tregon për një pakënaqësi të madhe për punën e institucioneve dhe mënyrën e politikbërjes në Kosovë.

Duke u bazuar në këtë, qytetarët, gjithashtu e vlerësojnë të dobët dhe joefikase punën e qeverisë. Nga të gjithë të anketuarit 72 për qind e tyre vlerësojnë se janë të pakënaqur me punën e qeverisë në vitin e parë të saj, ndërsa 26 për qind e tyre mendojnë se qeveria ka punuar mjaft mirë deri në këtë periudhë.

Ngjashëm si për qeverinë, qytetarët kanë të njëjtin vlerësim edhe për punën e deputetëve dhe Kuvendit të






Figura 10. Perceptimi i qytetarëve lidhur me drejtimin e gjërave në Kosovë



Figura 11. Perceptimi i qytetarëve lidhur punën e Qeverisë së Kosovës

Kosovës. Vetëm 26 për qind e qytetarëve e vlerësojnë pozitivisht punën e Kuvendit të Kosovës, ndërsa 72 për qind e vlerësojnë negativisht punën e Kuvendit të Kosovës.

4.2 Pjesëmarrja e votuesve në dy proceset e kaluara zgjedhore

Për të analizuar më mirë shkaqet e votave të pavlefshme në Kosovë dhe nevojës për reformën zgjedhore në Kosovë, në hulumtim janë përfshirë edhe pyetje që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen e votuesve në zgjedhje.

Në pyetjen se çfarë marrin parasysh qytetarët kur votojnë për një parti politike, vërehet se të anketuarit, në mënyrë pothuajse të barabartë marrin parasysh partinë politike në tërësi, pastaj liderin e partisë dhe listën e kandidatëve.

Mirëpo, nëse bëhet një ndarje sipas mënyrës se si të anketuarit kanë votuar në zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare të 11 qershorit 2018, atëherë vërehet dallim i qartë i qëndrimeve të votueseve të subjekteve të ndryshme politike rreth asaj se çfarë marrin parasysh kur e votojnë një subjekt politik. Me qëllim të paraqitjes së këtij raporti, koalicionit parazgjedhor ndërmjet Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Nisma për Kosovën (NK) dhe subjekteve tjera, në vijim të raportit do t'i referohemi si

koalicioni PAN. Ndërkaq koalicionit ndërmjet subjekteve politike Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Aleanca Kosova e re (AKR) dhe Alternativa, do t'i referohemi si koalicioni LAA.

Votuesit e koalicionit PAN, në rast të votimit i konsiderojnë të rëndësishme: partinë, liderin dhe kandidatët. 33.9 për qind e respondentëve e cilësojnë të rëndësishme partinë politike, 34.2 për qind liderin, 30.6 për qind e marrin parasysh listën e kandidatëve, ndërsa vetëm 1.3 për qind e tyre marrin parasysh elemente të tjera.

E njëjta nuk mund të thuhet për votuesit e koalicionit LAA. Shumica e tyre, respektivisht rreth 42.4 për qind, konsiderojnë se tërësia e partisë politike si e tillë është ajo që luan rol në përcaktimin e tyre gjatë votimit. Lideri i partisë është me rëndësi për 23.8 për qind të respondentëve, teksa lista e kandidatëve është e rëndësishme për 32 për qind e atyre që kanë votuar këtë koalicion.

Për dallim nga votuesit e të dy koalicioneve të sipërpërmendura, votuesit të cilët kanë votuar Lëvizjen Vetëvendosje (LVV) në zgjedhjet e kaluara, vërehet qartazi se më së shumti bazohen në liderin e partisë kur votojnë në zgjedhje. Shprehur në përqindje, rreth 38.6 për qind e

tyre marrin parasysh liderin, listën e kandidatëve 29.6 për qind, si dhe 27.5 për qind partinë politike.

Nga ky hulumtim del se 75 për qind e të anketuarve kanë deklaruar se kanë marrë pjesë në zgjedhjet e 11 qershorit. Të gjithë të anketuarit janë pyetur edhe se cila është mënyra më e mirë për të treguar se nuk e preferojnë asnjë subjekt politik në rast të zgjedhjeve. Rezultatet tregojnë se mospjesëmarrja në zgjedhje, me 41.7 për qind, është mënyra e mirë për të treguar se nuk kanë asnjë subjekt të preferuar politik. Pjesa tjetër prej 38.2 për qind, vlerëson se duhet të marrin pjesë në zgjedhje.

Në rastin kur nuk kanë preferencë politike, qytetarët prishin qëllimshëm fletëvotimin. Ndërsa, 19 për qind, mendon se lënia e zbrazët e fletëvotimit është një mënyrë tjetër për të treguar se nuk kanë ndonjë subjekt të preferuar politik.

Nga kjo mund të konkludohet se një pjesë e votave të pavlefshme, në përqindje jo të madhe mund të jetë edhe si rezultat i pakënaqësisë qytetare me subjektet politike. Kësisoj ata e shfrytëzojnë të drejtën e tyre demokratike për të marrë pjesë në zgjedhje, por duke prishur qëllimisht fletëvotimin ose duke e lënë të zbrazët.

	PARTINË POLITIKE	LIDERIN E PARTISË POLITIKE	KANDIDATËT	TJETËR
KOALICIONI PAN (PDK, AAK, NISMA)	33.9%	34.2%	30.6%	1.3%
KOALICIONI LAA (LDK, AKR, ALTERNATIVA)	42.4%	23.8%	32.0%	1.7%
LËVIZJA VETËVENDOSJE!	27.5%	38.5%	29.6%	4.3%
LISTA SERBE	93.1%	6.9%	0%	0%
TJETËR	30%	20%	50%	0%

Figura 12. Deklarimi i qytetarëve lidhur elementet që marrin parasysh kur votojnë për një subjekt të caktuar politik (Të anketuarit janë ndarë sipas deklarimit të votës së tyre në zgjedhjet e 11 qershorit 2018)

SA KANDIDATË TË SUBJEKTIT POLITIK KENI VOTUAR NË FLETËVOTIMIN PËR KUVENDIN KOMUNAL?




Figura 13. Deklarimi i të anketuarve se sa kandidatë kanë votuar në fletëvotimin për Kuvendin Komunal, në zgjedhjet e 22 tetorit të vitit 2017

Pjesa në vazhdim e raportit do të fokusohet në zgjedhjet lokale të 22 tetorit 2017.

Nga të gjithë të anketuarit, 79.1 për qind e tyre kanë deklaruar se kanë marrë pjesë në zgjedhjet lokale të organizuara me 22 tetor 2018, ndërkohë 14.6 për qind e tyre nuk kanë marrë pjesë në zgjedhje. Pjesa tjetër prej 4.4 për qind nuk ka marrë pjesë në zgjedhje për shkak se nuk ka pasur të drejtë vote.

1.9 për qind e të anketuarve kanë refuzuar të përgjigjen. Kjo e dhënë tregon se në përgjithësi ekziston një trend më i lartë i pjesëmarrjes së qytetarëve në zgjedhjet lokale, sesa në ato parlamentare.

Sipas legjislacionit në fuqi, në zgjedhjet lokale në Kosovë, në raundin e parë votohet edhe për kryetarin e komunës dhe për anëtarët e Kuvendit komunal me dy fletëvotime të ndryshme, që i marrin votuesit. Të anketuarit janë pyetur edhe për numrin kandidatëve që kanë votuar në zgjedhjet për kuvende komunale. Të dhënat tregojnë se një 26.7 për qind kanë votuar për pesë kandidatë, që i bie se vota e

tyre ka shkuar vetëm për partinë, dhe për asnjë nga kandidatët. Për më shumë, kjo tregon se ka pasur një mungesë të qartë të informimit dhe edukimit të votuesve nga ana e KQZ-së, meqë vetëm katër muaj para këtyre zgjedhjeve, janë mbajtur zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare ku janë votuar deri në pesë kandidatë, që për nga natyra e problemit shpërfaqë qartë defektet e këtyre fushatave. Nga ata të cilët janë deklaruar se kanë marrë pjesë në zgjedhjet lokale të vitit të kaluar, 11.4 për qind kanë pasur nevojë për asistencë gjatë votimit. 38.3 për qind e tyre kanë deklaruar se asistencën e kanë marrë nga familjarët e tyre, 33.4 për qind një ndihmë të tillë e kanë marrë nga shoku/shoqja, teksa 20.4 për qind nga zyrtarët përgjegjës të vendvotimit.

Në zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare të mbajtura më 11 qershor 2017, 75.2 për qind e të anketuarve kanë deklaruar se kanë marrë pjesë, ndërsa rreth 20 për qind e tyre nuk kanë marrë pjesë. Sipas deklarimeve të të anketuarve, 63.8 për qind e tyre kanë votuar nga pesë kandidatë, ndërsa pjesa tjetër prej 23.9 për qind kanë votuar më pak se sa pesë kandidatë.

SA KANDIDATË TË NJË SUBJEKTI KENI ZGJEDHUR NË FLETËVOTIMIN TUAJ NË ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E KOSOVËS?




Figura 14. Deklarimi i të anketuarve se sa kandidatë kanë votuar në fletëvotimin për Kuvendin e Kosovës, në zgjedhjet e 11 qershorit të vitit 2017

|||||




Figura 15. Deklarimi i të anketuarve se çfarë marrin parasysh ata kur vendosin të votojnë për kandidatët e subjektit që kanë votuar, në zgjedhjet e 11 qershorit të vitit 2017

Në pyetjen se si janë përcaktuar për të votuar kandidatët e këtyre subjekteve politike, respondentët i janë referuar popullaritetit të kandidatit. 56 për qind e tyre kanë votuar kandidatët më të popullarizuar me prezencën e tyre në fushatë. 40.4 për qind e të anketuarve kanë votuar kandidatët që kanë qenë të komunës, zonës apo rajonit të tyre. Faktor tjetër përcaktues kanë qenë edhe kandidatët e rinj në listat zgjedhore (33.6 për qind).

24.8 për qind e të anketuarve kanë votuar kandidatët që i kanë njohur personalisht, 21.4 për qind kanë votuar kandidatet gra në lista, si dhe 18.5 për qind e tyre kanë votuar për kandidatët e rekomanduar nga dikush tjetër.

4.3 Çfarë sistemi zgjedhor preferojnë qytetarët e Kosovës

Qëllimi i përgjithshëm i këtij raporti është që të përfshijë elemente të ndryshme të reformës zgjedhore, e cila përfshinë edhe qytetarët e këtij vendi. Me qëllim të realizimit sa më të mirë të kësaj reforme dhe pjesëmarrjes qytet-

are, një pjesë e konsiderueshme e hulumtimit të opinionit publik i është kushtuar preferencave qytetare për sistemin zgjedhor. Gjithmonë duke pas parasysh edhe njohuritë elementare të qytetarëve sa i përket termeve dhe definicioneve që parasheh legjislacioni zgjedhor.

Pjesë e rëndësishme e reformës zgjedhore janë edhe zonat zgjedhore. Kosova është një zonë zgjedhore ku subjektet politike garojnë me lista të hapura për 100 nga 120 vendet e parlamentit të Kosovës, ndërsa pjesa tjetër prej 20 ulëseve janë të garantuara për komunitetet e tjera jo shumicë të parapara me Kushtetutën e Kosovës.

Në pyetjen se sa zona zgjedhore duhet të ketë Kosova, të anketuarit janë deklaruar pothuajse në përqindjen e barabartë në favor të idesë për një apo shumë zona zgjedhore. Në favor të një zone zgjedhore janë deklaruar 41.6 për qind e anketuarve, ndërsa për më shumë zona janë shprehur 40.1 për qind e të anketuarve.

42.2 për qind e tyre kanë thënë se deputetët duhet të përfaqësojnë interesat e të gjithë qytetarëve të Kosovës, pa marrë parasysh nga cila zonë vijnë.

|||||




Figura 16. Preferencat e të anketuarve për sistemin zonal të zgjedhjeve në Kosovë

Arsyetimi i të anketuarve që preferojnë më shumë se një zonë zgjedhore është se interesat e një zone të caktuar, mbrohen më së miri nga të zgjedhurit e asaj zone. Kjo shkak i përfaqësimit në Kuvendin e Kosovës, ku duhet ekzistoj edhe përfaqësimi regjional, ndërkohë që përfaqësimi i qytetarëve nëpër zona të ndryshme nuk është bërë në mënyrën më të mirë nga deputetët e Kuvendit të Kosovës. Figura e mëposhtme tregon arsyet se përse të anketuarit kanë preferenca për më shumë zona zgjedhore në Kosovë.

Duke konsideruar faktin se llogaridhënia politike dhe komunikimi ndërmjet qytetarëve dhe të zgjedhurve është në nivel të pakënaqshëm, kjo ndoshta shkak i sistemit aktual me një zonë zgjedhore ku një deputet mund të marrë vota në të gjithë Kosovën. Nga 1,200 të anketuar, 80.9 për qind e tyre kanë deklaruar se nuk kanë pas asnjë komunikim me deputetët e zgjedhur që nga zgjedhjet e fundit parlamentare. Arsye e mos komunikimit, sipas tyre është mosinteresimi i tyre për të kontaktuar deputetët, sikurse edhe deputetët, të cilët nuk kanë bërë ndonjë përpjekje për t' i takuar qytetarët.




Figura 17. Deklarimi i të anketuarve lidhur me arsyet se pse sipas tyre Kosova duhet të mbetet një zonë e vetme zgjedhore

|||||




Figura 18. Preferencat e të anketuarve lidhur me prapun zgjedhor në zgjedhjet e përgjithshme parlamentare në Kosovë

Sa i përket pragut zgjedhor, shumica e të anketuarve, apo 41.9 për qind, preferojnë pragu mbi 5 për qind (sistemi aktual), për shkak se Kuvendi i Kosovës nuk duhet të përbëhet vetëm nga partitë e vogla. Ndërsa, 21.7 për qind e tyre preferojnë që pragu të jetë nga 3-5 për qind, që të sigurohet një përfaqësim i subjekteve që gëzojnë një mbështetje të përgjithshme qytetare.

69.1 për qind e të anketuarve kërkojnë që të mbahen ende listat e hapura, për të shprehur preferencën e tyre për kandidatët e caktuar nga subjektet politike, ndërsa 23 për qind janë për opsionin me lista të mbyllura.


Listat e hapura nënkuptojnë votën për kandidatët në listë. Me legjislacionin aktual, në zgjedhjet parlamentare në Kosovë mund të votohen deri në pesë kandidatë të subjektit të caktuar politik. Në pyetjen se sa kandidatë preferojnë që qytetarët t'i votojnë në zgjedhje, 42 për qind e tyre, shkak i familjarizimit me sistemin zgjedhor, preferojnë që të mbetet mënyra e njëjtë e votimit, me të cilën ata mund të votojnë deri në pesë kandidatë. Pjesa tjetër preferon një kandidat, apo deri në tre kandidatë.

Është shumë e rëndësishme të potencohet se 68.9 për qind e të anketuarve kërkojnë që kuota gjinore prej 30 për qind që është me legjislacionin në fuqi të vazhdojë të mbahet edhe më tej.

Sa i përket zgjedhjes së presidentit të vendit, 88.3 për qind e të anketuarve preferojnë që zgjedhja e presidentit të bëhet direkt nga qytetarët e vendit, ndërsa 8.1 për qind e tyre preferojnë që ai të zgjidhet nga Kuvendi i Kosovës.

Përfaqësimi i drejtpërdrejtë qytetar dhe vota direkte për kryetarët e komunave përmes dy raundeve të zgjedhjeve lokale përfshirë edhe balotazhin, tregon se qytetarët ende preferojnë që përmes votës së tyre të vendosin për personin që do t'i udhëheqë ata. Si rrjedhojë 91.1 për qind e të anketuarve kanë deklaruar se kryetari i komunës duhet të zgjidhet drejtpërdrejtë nga qytetarët. Por, në rast se asnjëri kandidatë nuk e arrijnë prapun e votave prej 50 për qind +1 votë, 58.2 për qind e të anketuarve kanë shprehur preferencën e tyre që ta zgjedhin kryetarin përmes balotazhit, ndërsa 41.8 për qind e tyre nuk kanë preferuar balotazhin, duke lënë mundësinë që kandidati me më së shumti vota në raundin e parë, të marrë përsipër drejtimin e komunës.

|||||



Nga të anketuarit në fund janë marrë edhe përshtypje dhe komente mbi dizajnin dhe strukturën e fletëvotimit, për të parë nëse ndonjë nga elementet e fletëvotimit ka nevojë për përmirësim apo ndryshim.

Nga gjithsej 1,200 respondentë të këtij hulumtimi, 95.92 për qind e tyre kanë pranuar të plotësojnë dizajnin e ri të fletëvotimit. Kurse, përqindja e përgjithshme e të anketuarve që i kanë bërë fletëvotimet e tyre të pavlefshme është 3.7 për qind. Përlllogaritja e votave të pavlefshme, është bërë duke u bazuar në rregullat aktuale për shpalljen e fletëvotimeve të pavlefshme, që përfshinë fletëvotimet ku nuk është shënuar asnjë ekip futbollistik²⁶, fletëvotimet ku janë shënuar dy apo më shumë ekipe dhe fletëvotimet të cilat janë lënë qëllimisht të paplotësuara nga të anketuarit.

Parë nga natyra e pavlefshmërisë, 67.44 për qind e fletëvotimeve të pavlefshme, janë shpallur të tilla për shkak se janë shënjuar dy apo më shumë ekipe futbolistike. Vlen të ritheksohet se këto rezultate paraqesin një nga limitimet kryesore të hulumtimit, duke qenë se jo gjithherë ekipet futbolistike asocojnë me subjektet politike. Po ashtu, janë mjaft të shpeshta rastet kur të anketuarit që kanë shënjuar dy apo më shumë ekipe, kanë

26 Me qëllim të evitimit të shkeljeve eventuale, në këtë fletëvotim, në vend të subjekteve politike janë paraqitur ekipe futbollistike. Kjo është një nga metodat më të përhapura për testimin e dizajneve të reja të fletëvotimeve.

|||||




Figura 20. Krahasimi i votave të vlefshme dhe atyre të pavlefshme, sipas rezultateve të testimit të dizajnit të ri të fletëvotimit, dhe rezultateve të zgjedhjeve të 11 qershorit të vitit 2017

deklaruar se preferojnë të dy ekipet, por në zgjedhje do të votonin vetëm për një subjekt politik.

16.28 për qind e fletëvotimeve janë të pavlefshme pasi që janë dëmtuar qëllimisht nga të anketuarit. Një pjesë e konsiderueshme e kësaj përqindje, janë gratë e anketuara të cilat kanë deklaruar se nuk kanë preferenca për ekipet futbolistike, që paraqet po ashtu limitim metodologjik të hulumtimit.

Në anën tjetër, në 13.95 për qind të fletëvotimeve të pavlefshme janë shënuar vetëm kandidatët, por jo edhe ekipi. Kjo në fakt paraqet të arriturën kryesore të testimit, meqë është vërtetuar se me dizajnin e ri, është ulur ndjeshëm përqindja e fletëvotimeve të pavlefshme të këtij lloji, që në zgjedhjet e kaluara ka paraqitur rreth 40 për qind të numrit të përgjithshëm të fletëvotimeve.

Në fund, pjesa tjetër e fletëvotimeve të pavlefshme (2.33 për qind), kanë qenë të paplotësuar.




Figura 21. Ndarja e fletëvotimeve të pavlefshme (3.7 për qind) për nga natyra e pavlefshmërisë së tyre

|||||

|||||

Përveç plotësimit dhe evidentimit të natyrës së pavlefshmërisë së fletëvotimeve të dizajnuara, element tjetër i rëndësishëm i testimit fizik ka qenë edhe evidentimi i aspekteve të tjera, si kërkesa për ndihmë në plotësimin e fletëvotimit, kënaqshmëria me strukturën, dizajnin dhe informatat e ofruara në fletëvotimin e ri. Vlen të ceket që për të gjitha këto aspekte janë marrë preferencat dhe qëndrimet e të anketuarve për të dy pjesët e fletëvotimit, pra, pjesën e ekipit dhe pjesën e kandidatëve.

Në përgjithësi janë 24.7 për qind e të anketuarve që kanë kërkuar ndihmë në plotësimin e pjesës së ekipeve, dhe 25.4 për qind që kanë kërkuar ndihmë në plotësimin e

pjesës së kandidatëve. Në këtë drejtim, nëse të anketuarit ndahen në baza gjinore, atëherë del se gratë (27.7 për qind) kanë kërkuar ndihmë në përqindje pak më të lartë sesa burrat (21.7 për qind).

Nga aspekti i ndarjes në grup moshë të të anketuarve, del se në përgjithësi, sa më të vjetër që kanë qenë të anketuarit që kanë plotësuar fletëvotimin, aq më shumë është rritur përqindja e tyre që kanë kërkuar ndihmë për plotësimin e pjesëve të tij. Përqindjet e të anketuarve, të ndarë sipas grup moshave, që kanë kërkuar ndihmë në plotësimin e dy pjesëve të fletëvotimit, janë si në vijim:




Figura 22. Të anketuarit që kanë kërkuar ndihmë në plotësimin e fletëvotimit, të ndarë sipas grupmoshave

Faktor tjetër domethënës në përqindjen e lartë të fletëvotimeve është edhe niveli i edukimit të qytetarëve. Nëse merret për bazë ky parametër, të dhënat e këtij hulumtimi tregojnë se të anketuarit me nivel më të ulët të edukimit, kanë

nivelo më të larta të kërkesës për ndihmë në plotësimin e dy pjesëve të fletëvotimit. Konkludim kryesor i kësaj analize është se sa më të edukuar që të jenë qytetarët, aq më pak kanë nevojë për ndihmë apo asistencë gjatë votimit.




Figura 23. Të anketuarit që kanë kërkuar ndihmë në plotësimin fletëvotimit, të ndarë sipas nivelit të edukimit

|||||

Në fund të pjesës së testimit fizik të dizajnit të ri të fletëvotimit, janë marrë edhe përshtypjet e të anketuarve lidhur me udhëzimet e paraqitura në fletëvotim, dizajnin dhe në përgjithësi strukturën e fletëvotimit të ri. Bazuar në metodën e vrojtimit, anketuesit kanë konstatuar se 31.2 për qind e të anketuarve i kanë lexuar instruksionet e paraqitura në fletëvotim, e të cilat dallojnë nga versioni paraprak i fletëvotimit. Kjo përqindje është më e theksuar në mesin e grup moshave të reja, ndërsa ka rënie drastike tek votuesit në moshë më të shtyrë, shumica dërrmuese e të cilëve nuk i kanë lexuar fare instruksionet. Ndërsa, në përgjithësi, mbi 90 për qind e të anketuarve janë pajtuar se udhëzimet e reja në fletëvotim janë të qarta. Në anën tjetër, vetëm 9.1 e të anketuarve nuk janë pajtuar se udhëzimet në fletëvotim janë të qarta. Përqindje dhe trende të ngjashme janë evidentuar edhe në pyetjet për strukturën dhe dizajnin e fletëvotimit.

90.4 për qind e të anketuarve kanë deklaruar që pajtohen se dizajni dhe struktura e fletëvotimit janë të mira, ndërsa vetëm 9.6 për qind nuk janë pajtuar që dizajni dhe struktura e fletëvotimit të ri janë të mira. Sipas ndarjeve në rajone të të anketuarve, Peja dhe Ferizaj kanë përqindjen më të lartë të pëlqyeshmërisë së deklaruar për strukturën dhe dizajnin e fletëvotimit me 99.2 për qind. Pas tyre, renditet rajoni i Gjakovës me 97.8 për qind, Mitrovica me 95.8 për qind, Gjilani me 91.6 për qind dhe Prishtina me 85.6 për qind. Rajoni me nivelin më të ulët të pëlqyeshmërisë për strukturën dhe dizajnin e fletëvotimit, krahasuar me të gjitha rajonet tjera, është Prizreni me 71.6 për qind.

Rreth 17.7 për qind e të anketuarve kanë komentuar lidhur me pjesë të caktuara të fletëvotimit. Këto komente janë marrë parasysh dhe janë adresuar në versionin përfundimtar të fletëvotimit.

90.4%

e të anketuarve kanë deklaruar që pajtohen se dizajni dhe struktura e fletëvotimit janë të mira, ndërsa vetëm 9.6 për qind nuk janë pajtuar që dizajni dhe struktura e fletëvotimit të ri janë të mira.



DIZAJNI DHE STRUKTURA E FLETËVOTIMIT JANË TË MIRA:




Figura 24. Të anketuarit që kanë kërkuar ndihmë në plotësimin fletëvotimit, të ndarë sipas nivelit të edukimit

Sa i përket fletëvotimeve të pavlefshme, mund të konkludohet se nuk ekziston vetëm një faktor përcaktues, që ka sjellë deri tek numri kaq i madh i fletëvotimeve të pavlefshme. Në këtë aspekt, rol kanë luajtur disa faktorë, si për shembull fushata joadekuate e KQZ-së për informim dhe edukim të votuesve, apo edhe fushatat e 'egra' çorientuese të subjekteve politike, të cilat janë fokusuar tek kandidatët, duke lënë krejtësisht në plan të dytë shënjimin e subjekteve politike në fletëvotim. Bazuar në analizën e shtrirjes së fletëvotimeve të pavlefshme në nivel vendi, mund të dilet me përfundimin se zonat urbane

Në të njëjtin hulumtim po ashtu vërehet se vetëm 29.7 për qind e grave të anketuara i kanë konsideruar si shumë të dobishme fushatat që KQZ-ja i zhvillon për edukim dhe informim të votuesve. Një tregues tilië po ashtu thekson nevojën që të ketë fshatë adekuate dhe të posaçme për gratë kur është fjala për informim lidhur me procesin e votimit.



REKOMANDIMET

Marrë parasysh të gjeturat e evidentuara në këtë raport, posaçërisht në funksion të adresimit të çështjes së numrit të madh të fletëvotimeve të pavlefshme, si dhe fushatat jo-adekuate për informim dhe edukim të votuesve, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), ofron rekomandimet, si në vijim:

1

Procesi i reformës zgjedhore duhet të përfundohet nga legjislatura aktuale. Në rast të shpërndarjes së Kuvendit para përfundimit të mandatit, legjislatura e re duhet që me prioritet t'a përfundojë këtë proces të vonuar;

2

Të gjitha subjektet politike duhet të marrin pjesë në procesin e reformës zgjedhore, me qëllim të gjithëpërfshirjes dhe dhënies së sa më shumë ideve për përmirësimin e sistemit aktual;

3

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, si institucion i përhershëm kushtetues, me mandat të rregullt, duhet të krijojë programe të veçanta informuese dhe edukuese për votuesit, dhe të mos i shoh ato vetëm si procese **ad-hoc**, të cilat ndodhin vetëm brenda periudhës prej shpalljes së zgjedhjeve deri te mbajtja e tyre;

4

Dizajnet e fletëvotimeve për të gjitha zgjedhjet në Kosovë, duhet të ndryshohen, duke i bërë ato më lehtë të kuptueshme;

5

Duhet të dizajnohen dhe prodhohen reklama të veçanta për komunitetet e ndryshme dhe ato të transmetohen në mediat lokale ku ata kanë qasje. Për shkak të refuzimit për të bashkëpunuar me institucionet shtetërore në veri, KQZ-ja mund të përdorë gatishmërinë e mediave të komunitetit serb në qendër dhe jug të vendit për të përçarur mesazhet e veta, në mënyrë që ato të mbërrijnë tek audienca e targetuar;

6

Në reklama preferohet të mos përdoren aktorë profesionistë, të cilët kanë rastisur që në disa fushata të janë të njëjtë, dhe janë fytyra të një sërë produkteve të tjera e të konsumuara. Kompanitë mund të organizojnë audicione me njerëz të zakonshëm që kanë gjasa më të mëdha të votojnë, pra të përcillet një mesazh me njerëzor;

7

Duhet të ketë dallimet në konceptet e fushatave për zgjedhjet lokale dhe qendrore. KQZ-ja nuk e ka bërë shumë deri tani këtë ndarje. Në këtë drejtim, duhet që në këto fushata të përfshihen ekspertë të fushave të ndryshme, OJQ-të si dhe grupet e ndryshme të interesit. Po ashtu, bashkërendimi i aktiviteteve me institucionet tjera shtetërore do të ishte vlerë e shtuar për fushatat. Shembull për këtë, do të mund të ishte bashkëpunimi me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për targetimin e të rinjve që ushtrojnë të drejtën e tyre për herë të parë, bashkëpunimi me Ministrinë e Punëve të Brendshme në raport me fushatat për informim dhe edukim të votuesve që janë të burgosur, apo edhe me OJQ-të që merren me çështjet që ndërlidhen me personat me aftësi të kufizuara, për t'i siguruar kësaj audience fushata sa më adekuate.

8

Duhet ngritur një mekanizëm të posaçëm vlerësimi për kompaninë që udhëheq fushatën për ta vlerësuar aspektin profesional të saj dhe përvojën dhe jo rrjedhimisht ofertën më të lirë;



**9**

Në zonat ku rezulton se ka më shumë fletëvotime të pavlefshme duhet që KQZ të përdorë mjete të tjera përveç komunikimit audio-vizual të fushatës. Duhet të simulojë dhe ofrojë mënyra të votimit dhe trajnime specifike si duhet votuar shumë javë para zgjedhjeve. Veçmas tek më të moshuarit të ketë trajtim më të veçantë;

10

Mesazhet të jenë të thjeshta, të shkurtra dhe të ndara për secilin grup etnik. Jo sikurse deri tani, ku një reklamë e prodhuar me aktorët shqiptarë është shoqëruar me titra në gjuhët respektive të Kosovës; (Për shembull, reklama motivuese e fundit për të rinj përmbajnë një mesazh në disa gjuhë). Miniumi çfarë mund të bëhet është që fleta me mesazh të shtypet në disa gjuhë, dhe të mos ndryshohet në procesin e montazhit, sepse secili mund ta vërejë se është e rreme

11

KQZ-ja duhet të punojë edhe me partitë politike dhe individët brenda tyre për t'ua shpjeguar që të heqin dorë nga fushatat e tyre për gjoja edukimin e votuesit, sepse në fakt kjo krijon shumë konfuzion dhe çon në gabime. Kërkesat e kandidatëve për ta votuar numrin e tyre në lista, ka ndikuar negativisht meqë votuesit kanë harruar shpesh të votojnë për numrin e partisë.

12

KQZ-ja të kërkojë nga partitë që përmes vullnetarëve të tyre t'i edukojnë ata për rëndësinë e votës dhe pjesëmarrjen në votime;

13

Duhet të punohet në përmbajtje dhe dizajn të materialeve të fushatës. Veçmas ato të KQZ-së të dallohen, sepse qytetarët shpesh mendojnë që janë nga ndonjë subjekt politik dhe për pasojë nuk i kushtojnë vëmendje;

14

KQZ-ja ta shohë me prioritet fushatën e informimit të publikut sikurse aspektet e tjera të organizimit teknik dhe përmbajtjesor të zgjedhjeve prej fletëvotimeve, komisionerëve e kërkesave të tjera se sa fushatës; KQZ-ja kryesisht e ka shikuar aspektin e fushatës së informimit si përmbushje obligimi ligjor por pa e mbikëqyrur dhe udhëhequr atë në detaje. Ata e shohin si një përmbushje të një obligimi ligjor dhe jo si një pjesë e rëndësishme e jetike e tërë organizimit të zgjedhjeve, gjë që duhet të ndryshojë.

15

Të bëhet një riorganizim institucional e ligjor brenda KQZ-së për të siguruar një fushatë më të mirë vetëdijesimi;

16

Reklama të papranueshme nga KQZ të cilat e shpjegojnë aspektin teknik të organizimit dhe mbarëvajtjes që është në përgjegjësi të komisionerëve të trajnuar dhe që paguhen për këtë gjë. Kjo ka fare pak rëndësi për qytetarët se kush çfarë bën në procesin pasi të mbyllen votimet. Kjo është kosto, e cila do të duhej të koncentrohej në edukimin dhe vetëdijesimin e qytetarëve për zgjedhjet;

17

Gjuhë me e thjeshtë dhe imazhe më të forta, që mbahen lehtë në mend. Për shembull, thuhet 'votoni jo më pak se pesë'...që do të mund të zëvendësohej me 'votoni deri në 5 kandidatë e jo më shumë;

18

KQZ-ja duhet të arrijë fizikisht sikurse partitë, të organizojë një grup vullnetarësh për t'ua shpjeguar njerëzve si votohet. Këtë mund ta bëjë në së paku 7 qendrat e mëdha të vendit

19

Të prodhohen video, që janë të natyrës së raporteve televizive të lajmeve, të cilat mund të trajtojnë aspekte të veçanta të vetëdijesimit të votuesve dhe ta pasqyrojë edhe vetë fushatën e KQZ-së për informim publik. Ato mund të transmetohen në pauzat e debateve më të shikuara politike në televizione.





20

Preferohet që mesazhet e KQZ-së të vijnë ekskluzivisht nga kryetarja e KQZ-së dhe kryeshefi ekzekutiv, si individë profesionalë të organizimit të procesit zgjedhor për të shmangur, qoftë në pamje, figurat politike që publiku zakonisht i identifikon nëpërmjet përplasjeve në mbledhjet e KQZ-së

21

Të shtohet ndjeshëm aktiviteti në mediat sociale që targetojnë audiencën e re, shumë prej tyre që votojnë për herë të parë. Hulumtimi i opinionit publik i KDI-së vë në pah se vetëm 17.6 për qind e të anketuarve kanë marrë informacione nga rrjetet sociale sa i përket procedurave të votimit.

22

Faqet zyrtare në Facebook, Twitter dhe Instagram zakonisht përmbajnë ose linqe të lajmeve në uebfaqen e KQZ-së, ose video pa shpjegim të mjaftueshëm. Për menaxhimin e mediave sociale do të duhej të kishte ekip të veçantë, e sidomos në ditën e zgjedhjeve. Të gjitha llogaritë, e sidomos ajo në Twitter do të duhej të ofronte informacione minutë pas minuti për mbarëvajtjen dhe më pas rezultatin e zgjedhjeve. Pika e fortë e KQZ-së është publikimi online i rezultateve në faqen elektronike. Ky veprim do të duhej të forcohej edhe më, shkak i interesimit të jashtëzakonshëm të votuesve në natën e shpalljes së rezultateve.



BIBLIOGRAFIA

Publikimet:

- Demokraci për Zhvillim (D4D). **"Trendet zgjedhore 2000-2014: Analizë numerike e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit"**. Prishtinë: Korrik, 2015.
- European Union Election Observation Mission (EUEOM). **"Two faces of Kosovo municipal elections"**. Prishtinë: 2017.
- Instituti Demokratik i Kosovë (KDI). **"Reforma në sistemin zgjedhor të Kosovës"**. Prishtinë: 2010.
- Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve në Kroaci: **"Përdorimi i sistemit të votimit elektronik"**. Zagreb: 2018.
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. **"Hulumtimi dhe analizimi i fletëvotimeve të pavlefshme për zgjedhjet për kuvendin komunal 2013"**. Prishtinë: 2014.
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. **"Hulumtimi dhe analizimi i fletëvotimeve të pavlefshme për zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2014"**. Prishtinë: 2015.
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. **"Strategjia për Informim të Publikut"**. Prishtinë: 2017.
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. **"Zgjedhjet në Kosovë 2000 – 2014"**. Prishtinë: 2017.
- National Democratic Institute Kosovo (NDI). **"Kosovo's June 2017 Parliamentary Elections"**. Prishtinë: 2017.
- Office for Democratic Institutions and Human Rights (OSCE – ODIHR). **"Montenegro Presidential Elections 15 April 2018"**. Varshavë: 2018.

Intervistat:

- Beqiri, Azemine, **Intervistë personale**, Shtator 2018
- Halimi, Enis. **Intervistë personale**, Shtator 2018

Linqet:

- https://www.youtube.com/watch?v=y_2EJZALHxw
- <https://www.nbcnews.com/news/world/french-election-protest-vote-nobody-was-highest-half-century-n756261>: "French Election: Protest Vote for 'Nobody' Was Highest In Half a Century". NBC News. 2017

|||||

SHTOJCA I – Pyetësi për preferencat e subjekteve politike lidhur me elementet e sistemit zgjedhor të Kosovës

- 1) Çfarë sistemi zgjedhor duhet të ketë Kosova?
- 2) Sa zona zgjedhore vlerësoni se duhet të ketë Kosova?
- 3) A duhet që listat zgjedhore të mbeten të hapura apo të mbyllen?
- 4) Sa duhet të jetë pragu zgjedhor për zgjedhjet e nivelit qendror?
- 5) Si duhet të bëhet zgjedhja e Presidentit të Kosovës?
- 6) A duhet që komunitetet jo-shumicë të vazhdojnë të kenë 20 ulëse të garantuara në Kuvendin e Kosovës? Nëse jo, si duhet të rregullohet çështja e përfaqësimit të tyre?
- 7) Sa kandidatë duhet të kenë të drejtë qytetarët që t'i votojnë në zgjedhjet e përgjithshme?
- 8) A duhet që të lejohet votimi me kusht dhe votimi nga jashtë?
- 9) Sa duhet të jetë kuota për përfaqësim gjinor në zgjedhjet e përgjithshme dhe ato lokale?
- 10) Sa deputetë duhet të ketë Kuvendi i Kosovës?
- 11) Cili institucion duhet t'a kryejë auditimin e financave të subjekteve politike?
- 12) A duhet të ndryshojë dizajni i fletëvotimit?
- 13) Çfarë elementesh tjera shtesë duhet që duhet të përfshijë reforma zgjedhore?

|||||



ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PËR KUVENDIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS 2017
PREVREMENI IZBORI ZA SKUPŠTINU REPUBLIKE KOSOVO 2017
2017 KOSOVA CUMHURİYETİ MECLİSİ ERKEN SEÇİMLERİ



00000000

1

Votoni vetëm një
subjekt politik

Gljasajte samo za jedan
politički subjekat

Sadece bir siyasi varlık
için oy kullanınız

☐	111.		Club Atlético de Madrid
☐	112.		FC Barcelona
☐	113.		FC Bayern München
☐	114.		Club Brugge
☐	115.		PFC CSKA Moskva
☐	116.		Borussia Dortmund
☐	117.		Galatasaray AŞ
☐	118.		TSG 1899 Hoffenheim
☐	119.		FC Internazionale Milano
☐	120.		Juventus
☐	121.		Liverpool FC

2

Votoni deri në pesë kandidatë

Shënjoni deri në pesë kandidatë të subjektit politik që keni zgjedhur në anën e majtë

Gljasajte do pet kandidata

Označite do pet kandidata političkog subjekta kojeg ste odabrali na levoj strani

Beş adaya kadar oy kullanınız

Sol tarafta seçtiğiniz siyasi varlığın beş adayını işaretleyiniz

1	2	3	4	5
6	7	8	9	10
11	12	13	14	15
16	17	18	19	20
21	22	23	24	25
26	27	28	29	30
31	32	33	34	35
36	37	38	39	40

☐	122.	 FC Lokomotiv Moskva
☐	123.	 Olympique Lyonnais
☐	124.	 Manchester City FC
☐	125.	 Manchester United FC
☐	126.	 AS Monaco FC
☐	127.	 SSC Napoli
☐	128.	 Paris Saint-Germain
☐	129.	 FC Viktoria Plzeň
☐	130.	 FC Porto
☐	131.	 Real Madrid CF
☐	132.	 AS Roma
☐	133.	 FC Schalke 04
☐	134.	 FC Shakhtar Donetsk
☐	135.	 Tottenham Hotspur FC
☐	136.	 Valencia CF

	41	42	43	44	45
	46	47	48	49	50
	51	52	53	54	55
	56	57	58	59	60
	61	62	63	64	65
	66	67	68	69	70
	71	72	73	74	75
	76	77	78	79	80
	81	82	83	84	85
	86	87	88	89	90
	91	92	93	94	95
	96	97	98	99	100
	101	102	103	104	105
	106	107	108	109	110

00000000



Prishtinë | Priština | Prištine

ZGJEDHJET PËRKUVEND KOMUNAL 2017
IZBORI ZA SKUPŠTINU OPŠTINE 2017
BELEDIJE MECLISI SEÇIMLERI 2017



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republika Kosovo
Central Election Commission



1 **Votoni vetëm një subjekt politik** që nënkupton votë edhe për bartësin e listës
Gljasajte samo za jedan politički subjekat što podrazumeva glas i za nosioca liste
Sadece bir siyasi varlık için oy kullanınız ki bu liste taşıyıcısı için de oy anlamına gelir

☐	111.		Club Atlético de Madrid
☐	112.		FC Barcelona
☐	113.		FC Bayern München
☐	114.		Club Brugge
☐	115.		PFC CSKA Moskva
☐	116.		Borussia Dortmund
☐	117.		Galatasaray AŞ
☐	118.		TSG 1899 Hoffenheim
☐	119.		FC Internazionale Milano
☐	120.		Juventus

2 **Votoni vetëm një kandidat** Shënjoni vetëm një kandidat të subjektit politik që keni zgjedhur në anën e majtë
Gljasajte samo za jednog kandidata Označite samo jednog kandidata političkog subjekta kojeg ste izabrali na levoj strani
Sadece bir aday için oy kullanınız Sol tarafta seçtiğiniz siyasi varlığın sadece bir adayını işaretleyiniz

☐	2	☐	3	☐	4	☐	5	☐	6
☐	7	☐	8	☐	9	☐	10	☐	11
☐	12	☐	13	☐	14	☐	15	☐	16
☐	17	☐	18	☐	19	☐	20	☐	21
☐	22	☐	23	☐	24	☐	25	☐	26
☐	27	☐	28	☐	29	☐	30	☐	31
☐	32	☐	33	☐	34	☐	35	☐	36

☐	121.	 Liverpool FC
☐	122.	 FC Lokomotiv Moskva
☐	123.	 Olympique Lyonnais
☐	124.	 Manchester City FC
☐	125.	 Manchester United FC
☐	126.	 AS Monaco FC

☐	☐	☐	☐	☐	☐
☐	37	38	39	40	41
☐	42	43	44	45	46
☐	47	48	49	50	51
☐	52	53	54	55	56



00000000

Prishtinë | Priština | Prištine



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



ZGJEDHJET PËR KRYETAR KOMUNE 2017
IZBORI ZA SKUPŠTINU OPŠTINE 2017
BELEDIJE MECLISI SEÇIMLERI 2017

**Votoni vetëm një
kandidat**

**Glasajte samo za
jednog kandidata**

**Sadece bir aday için
oy kullanınız**

☐

10.

**Antoine Griezmann**

Club Atlético de Madrid

☐

30.

**Lionel Messi**

FC Barcelona

☐

33.

**Manuel Neuer**

FC Bayern München

☐

41.

**Mats Rits**

Club Brugge

☐

48.

**Vitali Zhironkin**

CSKA Moskva

☐

55.

**Marco Reus**

Borussia Dortmund

☐

61.

**Eren Derdiyok**

Galatasaray AŞ

☐

88.

**David Otto**

TSG 1899 Hoffenheim

00000000



Prishtinë | Priština | Prištine



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



RAUNDI I DYTË I ZGJEDHJEVE PËR KRYETAR KOMUNE 2017
DRUGI KRUG IZBORA ZA PREDSEDNIKA OPŠTINE 2017
2017 BELEDIYE BAŞKANI SEÇİMLERİ'NİN İKİNCİ TURU

Votoni vetëm një
kandidat

Glasajte samo za
jednog kandidata

Sadece bir aday için
oy kullanınız



10.

**Antoine Griezmann**

Club Atlético de Madrid



30.

**Lionel Messi**

FC Barcelona



*KDI është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e angazhuar të mbështesë zhvillimin e demokracisë përmes përfshirjes së qytetarëve në bërjen e politikave publike dhe fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile me synimin për të ndikuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve publike.

Për më shumë informata rreth KDI ju lutem vizitoni www.kdi-kosova.org



RAPORTO
KORRUPSIONIN
0800 77 777